



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Data e fundit e azhurnimit: 14 dhjetor 2020

LIGJI Nr. 04/L-034¹

PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

ky është teksti i Ligjit i integruar me ndryshimet me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023

KY TEKST I SPASTRUAR I LIGJIT NUK PARAQET VERSIONIN ZYRTAR (për tekstin zyrtar të ligjit duhet referuar Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës)

Teksti i spastruar me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me ligjet vijuese është përpiluar me qëllim që lexuesi ta ketë më të lehtë të njoftohet me dispozitat pozitive që kanë të bëjnë me ligjin bazik² dhe ligjeve tjera përmes të cilave është bërë amandamentimi i Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

*Teksti me ngjyrë të **kuqe** paraqet dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-115³;
Teksti me ngjyrë të **blertë** paraqet dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-080⁴;
Teksti me ngjyrë të **kaltër** paraqet dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-023⁵;
Teksti i mesvijëzuar (shembull: ~~teksti~~), nënkupton dispozitën apo ndonjë fjalë të fshirë nga teksti i ligjit bazik).*

Nëse ndonjë dispozitë ligjore ka vlejtur deri në një datë të caktuar (p.sh. shih nenin 2 të Ligjit Nr. 04/L-115), atëherë teksti është mesvijëzuar dhe hijëzuar me të gjelbërt.

¹ Publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 19/2011. Ligji Nr. 04/L-034 ka hyrë në fuqi më 21 shtator 2011. Me këtë ligj është shfuqizuar Ligji nr. 03/L-067 për themelimin e AKP-së, në fuqi nga 1 korrik 2008 deri më 20 shtator 2011.

² Ligji bazik nënkupton Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023.

³ Publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 25/2012. Ligji Nr. 04/L-115 ka hyrë në fuqi më 7 shtator 2012 me rastin e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese (Gazeta Zyrtare nr. 25/2012) për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

⁴ Publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 38/2015. Ligji Nr. 05/L-080 ka hyrë në fuqi më 24 dhjetor 2015.

⁵ Publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 6/2018. Ligji Nr. 06/L-023 ka hyrë në fuqi më 3 maj 2018.

TABELA E PËRMBAJTJES SË LIGJIT TË AKP-së

KREU I STATUSI LIGJOR, QËLLIMET DHE PËRKUFIZIMET	2
Neni 1 Themelimi dhe statusi ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.....	2
Neni 2 Synimi dhe qëllimi	2
Neni 3 Përkufizimet	4
Neni 4 Referimet	7
KREU II DETYRAT DHE KOMPETENCAT E AGJENCISË	7
Neni 5 Ndërmarrjet dhe asetet nën autoritetin administrativ të Agjencisë	7
Neni 6 Fushëveprimi i kompetencave administrative të Agjencisë	9
Neni 6/A Kompensimi për pronat e shpronësuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.....	11
Neni 7 Ushtrimi i kompetencave.....	12
Neni 8 Themelimi i korporatave; shitja e aksioneve.....	12
Neni 9 Likuidimi i kryer nga Agjencia	13
Neni 10 Politika operative.....	14
KREU III ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI	15
Neni 11 Struktura organizative	15
Neni 12 Përbërja e Bordit.....	17
Neni 13 Mandati dhe Detyrat e Drejtorëve	18
Neni 14 Procedurat e Bordit.....	19
Neni 15 Përgjegjësitë e Bordit	20
Neni 16 Menaxhmenti dhe personeli	22
KREU IV DISPOZITAT FINANCIARE	23
Neni 17 Kapitali Themeltar.....	23
Neni 18 Detyrimet dhe Përgjegjësitë e Agjencisë.....	24
Neni 19 Politikat financiare, Identifikimi dhe transferimi i Fondeve Tepricë	25
Neni 19/A Kthimi i fondeve të përkohshme nga Qeveria.....	26
Neni 19/B Investimi i fondeve në mirëbesim.....	26
Neni 20 Raportet, buxheti dhe llogaritë	27
Neni 21 Financimi: të hyrat e dedikuara	28
Neni 22 Trajtimi i tatimeve	29
KREU V LLOGARIDHËNIA	29
Neni 23 Llogaridhënia e Bordit, Menaxhmentit dhe Personelit.....	29
Neni 24 Shpërndarja e Komisioneve të Shqyrtimit; zgjidhja e pretendimeve të pazgjidhura ..	29
Neni 25 Auditimet e jashtme.....	30
KREU VI ZBATIMI DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE.....	30
Neni 26 Ndihma nga Qeveria e Kosovës	30
Neni 27 Shqiptimi i gjobave.....	31
Neni 28 Përgjegjësia për dëme.....	31
Neni 29 Të drejtat e Agjencisë në procedurat ligjore kundër ndërmarrjeve	32
Neni 30 Paditë gjyqësore kundër Agjencisë	32
KREU VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	32
Neni 31 Ligji në fuqi	32
Neni 32 Hyrja në fuqi.....	33

TABELA E PËRMBAJTJES SË SHTOJCËS SË LIGJIT TË AKP-së

PJESA I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	34
Neni 1 Fushëveprimi dhe zbatueshmëria e kësaj Shtojce	34
Neni 2 Përkufizimet	34
Neni 3 Fushëveprimi	36
PJESA II PROCEDURAT FILLESTARE.....	36
Neni 4 Bazat për iniciimin e rasteve të likuidimit dhe vendimeve të likuidimit.....	36
Neni 5 Fillimi i likuidimit	36
Neni 6 Pasojat e vendimit të bordit për likuidim	36
Neni 7 Njoftimi për likuidim.....	36
Neni 8 Anulimi i të gjitha kontratave të punës.....	38
Neni 9 Ndërprerja e të drejtave të menaxhmentit të ndërmarrjes apo autoriteteve tjera menaxhuese	38
Neni 10 Pezullimi i veprimeve.....	39
Neni 11 Obligimet shërbyese të Ofruesve të shërbimeve publike	40
PJESA III AUTORITETI I LIKUIDIMIT	40
Neni 12 Themelimi i Autoritetit të Likuidimit; Caktimi i Anëtarëve	40
Neni 13 Përbërja e Autoritetit të Likuidimit	40
Neni 14 Emërimi i Ofruesve të Shërbimeve Profesionale	41
Neni 15 Kualifikimet e ofruesit të shërbimeve profesionale që shërben apo që ofron shërbime për Autoritetin e Likuidimit	41
Neni 16 Pagesa e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale dhe shpenzimeve tjera të likuidimit .	42
Neni 17 Detyrimet, kontabiliteti dhe raportimi	42
Neni 18 Përgjegjësitë dhe autorizimet e përgjithshme të Autoritetit të Likuidimit	44
Neni 19 Veprimet specifike të Autoritetit të Likuidimit	46
Neni 20 Pranimi dhe refuzimi i kontratave	48
Neni 21 Anulimi i transaksionit	48
Neni 22 Obligimi për të bashkëpunuar me Autoritetin e Likuidimit	49
PJESA IV KREDITORËT, TAKIMET E KREDITORËVE DHE DËSHMITË E KËRKESAVE	50
Neni 23 Dëshmitë e kërkesës apo interesit.....	50
Neni 24 Mbrojtja e interesave të kreditorëve	51
Neni 25 Takimi i Kreditorëve	52
Neni 26 Komiteti i Kreditorëve.....	52
PJESA V PRONA E NDËRMARRJES NË LIKUIDIM	54
Neni 27 Prona e ndërmarrjes në likuidim.....	54
Neni 28 Kufizimet në transferimin e pronës	54
Neni 29 Mallrat në transit në të cilat ndërmarrja ende nuk ka fituar të drejta pronësie	54
Neni 30 Prona e mbajtur në emër të palëve të treta	55
Neni 31 Të hyrat nga shitjet e pronës.....	55
Neni 32 Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës	55
Neni 33 Shpenzimet e shitjes	55
Neni 34 Mbrojtja adekuatë e aseteve që janë objekt i kërkesave të siguruara	56
PJESA VI KËRKESAT, PRIORITETET, SHPËRNDARJA	56
Neni 35 Njoftimi për kreditorin dhe Afati për parashtrimin e kërkesave	56

Neni 36 Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta	56
Neni 37 Llogaritja dhe kompensimi i kërkesave.....	58
Neni 38 Kërkesat e siguruara	59
Neni 39 Lista përfundimtare e Kërkesave.....	60
Neni 40 Prioritetet e kërkesave dhe interesave	60
Neni 41 Përmbushja e kërkesave dhe interesave	61
Neni 42 Fondet e rezervuara	62
PJESA VII MBYLLJA E RASTIT TË LIKUIDIMIT.....	63
Neni 43 Raporti përfundimtar	63
Neni 44 Mbyllja e rastit.....	64
Neni 45 Pasojat e mbylljes së rastit.....	64
Neni 46 Pushimi i autoritetit të likuidimit.....	64
Neni 47 Shuarja e borxheve	65
PJESA VIII DISPOZITA TË NDRYSHME	65
Neni 48 Udhëzimet e Gjykatës.....	65
Neni 49 Njoftimet dhe shpalljet publike	65
Neni 50 Gjuha e dokumenteve kryesore	66
PJESA IX SANKSIONET ADMINISTRATIVE.....	66
Neni 51 Parashtrimi i dokumenteve të rrejshme të kërkesës	66
Neni 52 Përvetësimet e paligjshme dhe fshehja e aseteve	66

LIGJI PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

TEKSTI I INTEGRUAR ME NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E BËRA NË BAZË TË

- I. **LIGJIT Nr. 04/L-115 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME PËRFUNDIMIN E MBIKËQYRJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS;**
- II. **LIGJIT Nr. 05/L-080 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-115;**

dhe
- III. **LIGJIT Nr. 06/L-023 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-115 DHE ME LIGJIN Nr. 05/L-080.**

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Me qëllim të nxjerrjes të legjislacionit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili është në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës;

Duke pasur parasysh se rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës si dhe mirëqenia e qytetarëve të saj është më rëndësi jetike dhe kërkon administrim, privatizimin dhe likuidim adekuat dhe me kohë të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore;

Duke pasur parasysh se për ndërmarrjet dhe asetet të cilat kanë qenë në pronësi shoqërore më datën 31 Dhjetor 1988 ose pas kësaj date mund të paraqiten potencialisht pretendime konfliktuoze pronësore, përfshirë këtu pretendimet pronësore private dhe shoqërore; dhe duke kuptuar se konstatimi i vlefshmërisë së këtyre pretendimeve, për shkak të kompleksitetit si të paraqitjes së provave ashtu edhe të normave të zbatueshme ligjore në të kaluarën, kërkon një masë të konsiderueshme të kohës dhe punës profesionale;

Duke pasur parasysh se pasiguria e vazhdueshme juridike lidhur me pronësinë e këtyre ndërmarrjeve dhe asetëve është duke i penguar në masë të madhe investimet dhe funksionimin e këtyre ndërmarrjeve dhe asetëve; po ashtu duke kuptuar se kjo pasiguri juridike është duke ndikuar në mënyrë serioze dhe negative në situatën e përgjithshme ekonomike dhe sociale në Kosovë, duke përfshirë, ndër tjera, rritjen e shkallës së papunësisë; uljen e prodhimit vendor; rritjen bilancit negativ tregtar të Kosovës; kufizimin e të ardhurave tatimore publike dhe fiskale; pengimin e

aftësisë së Kosovës për financimin e projekteve dhe programeve kyçe publike, duke përfshirë skemat e asistencës sociale, si dhe rritjen e kërkesës për këto skema;

I vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet substanciale negative ekonomike dhe sociale të cilat janë shfaqur si rezultat i kësaj pasigurie juridike si dhe për nxitjen e investimeve në këto ndërmarrje dhe asete përmes themelimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe delegimin në këtë Agjenci të autorizimeve të gjëra publike administrative mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

Gjithashtu i vendosur për të siguruar që çdo personi i cili pretendon se ka një interes ose të drejtë të pronësisë ose të kreditorit ndaj ose kundër një ndërmarrje ose aseteve, t'i jepet (i) e drejta adekuate për proces të drejtë që ngërthen dëgjimin dhe përcaktimin e vlefshmërisë së pretendimit të tij, dhe (ii) nëse ankesa konstatohet e vlefshme, të ketë të drejtën e kompensimit monetar për humbjen ose shkeljen e të drejtave ose interesave të tij; dhe

I vetëdijshëm se administrimi i ndërmarrjeve në pronësi publike do të rregullohet me ligj të veçantë;

Miraton

LIGJ PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

KREU I STATUSI LIGJOR, QËLLIMET DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1 Themelimi dhe statusi ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

1. Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”) është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

2. Agjencia është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Neni 2 Synimi dhe qëllimi

1. Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, Agjencia është e autorizuar për administrimin,

duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidikimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara në këtë ligj.

2. Për realizimin e këtij synimi, Agjencia:

~~2.1. deri në shitjen ose zgjidhjen në mënyrë tjetër sipas këtij ligji, mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe asete në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe dispozitat tjera të zbatueshme të së drejtës së Kosovës;~~

2.1. deri në shitjen ose zgjidhjen në mënyrë tjetër sipas këtij ligji, mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe asete në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionit në fuqi. Fondet e Përkohshme, ashtu siç definohen në këtë ligj, do të barten përkohësisht në një llogari të veçantë bankare në Thesarin e Kosovës dhe llogariten që janë pjesë e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës;

2.2. shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të këtij ligji, pa vonesa të panevojshme;

2.3. brenda kufizimeve të burimeve të veta administrative, ushtron aktivitete të arsyeshme ndihmëse për ruajtjen ose rritjen e vlerës, aktivitetit fitimprurës dhe qeverisjes së ndërmarrjeve dhe aseteve, deri në masën sa këto aktivitete nuk e pengojnë ushtrimin e detyrave të përcaktuara në nën-paragrafin 2.2 të këtij paragrafi;

~~2.4. në mënyrën dhe masën e paraparë në këtë ligj, përmbush pretendimet e vlefshme dhe të dorëzuara me kohë të kreditorëve dhe pronarëve lidhur me një ndërmarrje apo asete të caktuar, nga mjetet e realizuara nga shitja, transferimi, likuidimi ose zgjidhja tjetër e ndërmarrjes ose asetit; me ç'rast të gjitha këto të ardhura me përjashtim të Fondeve Tepricë do të mbahen në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët dhe do të ruhen nga Agjencia;~~

2.4. në mënyrën dhe masën e paraparë në këtë ligj, përmbush pretendimet e vlefshme dhe të dorëzuara me kohë të kreditorëve dhe pronarëve lidhur me një ndërmarrje apo asete të caktuara, nga mjetet e realizuara nga shitja, transferimi, likuidimi ose zgjidhja tjetër e ndërmarrjes ose asetit; me ç'rast të gjitha këto të ardhura me përjashtim të Fondeve Tepricë, Fondeve të Mbetura dhe Fondeve të Përkohshme do të mbahen në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët dhe do të ruhen nga Agjencia;

2.5. pas skadimit të afatit të dhënë për dorëzimin e pretendimeve të pronarëve dhe kreditorëve, në pajtim me nenin 19 paragrafi 3., kryen identifikimin dhe bartjen e të gjitha Fondeve Tepricë të cilat mbahen në mirëbesim nga Agjencia në Qeverinë e Kosovës;

2.6. Pas përmbushjes së vlefshme të kërkesave të kreditorëve në proces të likuidimit sipas Shtojcës së ligjit bazik, fondet e mbetura, nëse ka të tilla, barten nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës, dhe përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se Fondi në Mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas bartjes së fondeve të mbetura në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për

përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumën e nevojshme nga fondet e mbetura, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse;

2.7. Pas llogaritjes së shumës së nevojshme për përmbushjen e vendimeve të vlefshme të kërkesave kreditore në proces të likuidimit, sipas Shtojcës së ligjit bazik dhe pas llogaritjes së fondeve të nevojshme për aktivitetet dhe proceset ligjore tjera të Agjencisë, Fondet e Përkohshme, nëse ka të tilla, barten nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës, të cilat fonde të përkohshme përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se fondi në mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas transferimit të fondeve të përkohshme në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme apo për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë sipas ligjit bazik, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumën e nevojshme nga fondet e përkohshme, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit dhe mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë, që ndërlidhen me Ndërmarrjen Shoqërore përkatëse;

~~2.6.~~ 2.8. kryen detyra të tjera të cilat i janë dhënë sipas këtij ligji dhe dispozitave tjera ligjore të zbatueshme në Kosovë.

3. Ky ligj do të zbatohet në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollat e saj.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehje e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Agjenci** - Agjencia Kosovare e Privatizimit;

1.2. **Aset** - një aset, interes apo pronë mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin në përputhje me paragrafin 1. ose 2. të nenit 5 të këtij ligji;

1.3. **Bord** - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë;

1.4. **Akte nënligjore** - aktet nënligjore të Agjencisë të përkufizuara në nenin 14.1 të këtij ligji;

1.5. **Korporatë** - një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare e themeluar dhe regjistruar në Kosovë;

1.6. **Kreditor** - personi ose subjekti i cili ka një pretendim të vlefshëm si kreditor ndaj një ndërmarrje dhe/ose një aseti. “Kreditor” gjithashtu përfshin një person që ka një kërkesë të vlefshme si pronar i një aseti të caktuar;

1.7. **Drejtor** - anëtar i Bordit;

1.8. **Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive** - Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive;

1.9. **Ndërmarrje** - ndërmarrje mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin në përputhje me nenin 5.1.1.1 të këtij ligji;

1.10. **Sekretaria Ekzekutive** - sekretaria ekzekutive e Bordit e themeluar sipas nenit 11.5 të këtij ligji;

1.11. **RFJ dhe RSFJ** - respektivisht, ish-Republika Federative e Jugosllavisë dhe ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë;

~~1.12. **Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar** - autoriteti përgjegjës i përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 Mars 2007, për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Propozimi Gjithëpërfshirës;~~

1.13. **Ligji mbi Ndërmarrjet** - ligji mbi ndërmarrjet i RSFJ-së (77/88), i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet e RSFJ-së Nr. 40/89, 46/90 dhe 61/90;

1.14. **E Drejta e Kosovës** - Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tyre në pajtim me Kushtetutën, dhe legjislacioni që ka qenë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës nëse ai legjislacion vazhdon të jetë në fuqi sipas paragrafit 2. të nenit 145 të Kushtetutës. “E Drejta e Kosovës” nuk përfshinë asnjë ligj, legjislacion apo akt nënligjor, e as ndonjë pjesë të tyre, që është shfuqizuar, zëvendësuar, anuluar, është bërë i pavlefshëm në mënyrë të ligjshme apo zbatimi i të cilit ka përfunduar ligjërisht;

1.15. **Menaxhmenti** - Drejtori Menaxhues dhe Zëvendësdrejtorët Menaxhues të Agjencisë, kolektivisht dhe individualisht;

1.16. **Interesa në pronësi shtetërore** - cilido apo të gjithë interesat në pronësi shoqërore, përfshirë kapitalin shoqëror, në secilën ndërmarrje apo subjekt juridik që sipas nenit 159.2 të Kushtetutës, tani janë pronë e Republikës së Kosovës;

1.17. **Pronar** - personi ose subjekti i cili ka një pretendim të vlefshëm në një të drejtë ose interes pronësor në një ndërmarrje apo ndaj saj;

1.18. **Të ardhurat** - të ardhurat nga shitja, transferimi ose likuidimi i një ndërmarrje ose aseti sipas neneve 6, 8 ose 9 të këtij ligji, pas pagimit të taksave administrative të Agjencisë të parapara në nenin 21.2 të këtij ligji dhe pagesave që duhet të bëhen sipas nenit 10 të

Rregullores mbi Transformimin e Pronës së Patundshme;

1.19. **Ndërmarrje Publike** - një ndërmarrje e cila është identifikuar apo cilësuar në mënyrë të vlefshme si ndërmarrje në pronësi publike në bazë të dispozitës së nenit 3 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike;

1.20. **Ligji për Shoqëritë Tregtare** - Ligji Nr. 02/L-123 mbi Shoqëritë Tregtare;

1.21. **Rregullorja mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve** - Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2005/48 e datës 21 Tetor 2005 “mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve të tyre me Autorizimin Administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”;

1.22. **Rregullorja mbi Transformimin e Pronës së Patundshme** - Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13 e datës 9 Maj 2003, “mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme Shoqërore”;

~~1.23. **Fonde Tepricë** - të ardhurat që mbahen në mirëbesim nga Agjencia të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme, në pajtim me nenin 19.3, që nuk janë të nevojshme për përmbushjen e pretendimeve që janë parashtruar brenda afatit kohor nga kreditorët dhe pronarët përkatës;~~

1.23. **Fonde Tepricë** - të ardhurat që mbahen në mirëbesim nga Agjencia të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme, në pajtim me nenin 19 të ligjit bazik, që nuk janë të nevojshme për përmbushjen e pretendimeve që janë parashtruar brenda afatit kohor nga kreditorët dhe pronarët përkatës;

1.24. **Komision Shqyrtues** - një komision shqyrtues i themeluar sipas çfarëdo legjislacioni që i ka paraprirë këtij ligji: p.sh. Rregullorja për AKM-në apo Ligji Nr.03/L- 067;

1.25. **Ndërmarrje Shoqërore** - një person juridik (tjetër nga ndërmarrja në pronësi publike) i cili me apo pas datës 1 janar 1989, që:

1.25.1. përkon me paragrafin 1. ose 2. të nenit 2 të Ligjit mbi Ndërmarrjet;

1.25.2. përkon me paragrafin 3. të nenit 2 të Ligjit mbi Ndërmarrjet dhe shumica e asetëve të së cilës kanë qenë në pronësi shoqërore ose shumica e kapitalit të së cilit ishte e përbërë nga kapitali shoqëror; dhe

1.25.3. është regjistruar ose është dashur të regjistrohej në Kosovë sipas ligjit.

1.26. **Dhoma e Posaçme**⁶ - Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/13 të datës 13 Qershor 2002, “mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit” me ndryshimet dhe plotësimet e saj të bëra kohë pas kohe;

⁶ Ligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, publikuar në Gazetën Zyrtare më 27 Qershor 2019, në fuqi nga 13 Korrik 2019.

1.27. **Transformim** - lidhur me personin juridik, do të thotë cilado nga të mëposhtmet: bashkimi, transformimi, regjistrimi, ri-regjistrimi, inkorporimi si shoqëri aksionare apo si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, apo si person tjetër juridik, falimentimi, likuidimi, jolikuiditeti, organizimi në formë të veçantë apo në subjekt tjetër ose çfarëdo ngjarje apo procesi tjetër përmes të cilit ndryshohen cilado nga të poshtëshënuarat lidhur me atë subjekt: identiteti ligjor, forma apo natyra, ose forma apo natyra e pronësisë apo kapitalit, selia, dhe nëse ngjarja apo procesi i tillë apo ndonjë pjesë e tij ka ndodhur në cilëndo kohë ndërmjet 22 Marsit 1989 dhe 13 Qershorit 2002;

1.28. **Fondet e Mbetura** - të ardhurat që mbahen në mirëbesim nga Agjencia të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme, që mbesin pas përbushjes së obligimeve të parapara në nenin 40 dhe 41 të shtojcës së ligjit bazik;

1.29. **Fondet e Përkohshme** - të ardhurat e përcaktuara nga Agjencia në mënyrë të arsyeshme, që mbesin pas llogaritjes së përbushjes së obligimeve të parapara në nenin 2.7 të këtij ligji dhe neneve 40, 41 dhe 42 të shtojcës së ligjit bazik.

2. Fjalët e cilëndo gjini të përdorura në këtë ligj nënkuptojnë edhe gjininë tjetër dhe fjalët në numrin njëjës nënkuptojnë edhe numrin shumës dhe anasjelltas.

3. Termat që janë përkufizuar në nenin 2 të Shtojcës së këtij ligji, kurdo që përdoren në këtë ligj, e kanë kuptimin që është theksuar në atë nen përveç nëse konteksti brenda atij termi në mënyrë të qartë synon të japë kuptim tjetër.

Neni 4 Referimet

Përveç nëse konteksti në mënyrë të qartë kërkon një interpretim tjetër, të gjitha referencat në këtë ligj ndaj një ligji, Shtojcës së këtij ligji, një ligji, rregulloreje ose akti tjetër nënligjor, ose ndaj një dispozite të caktuar të tyre, duhet të interpretohen për të përfshirë të gjitha ndryshim-plotësimet pasuese të tyre. Nëse ligji, rregullorja ose akti nënligjor i sipër cekur shfuqizohet dhe zëvendësohet me legjislacion pasardhës mbi të njëjtën fushë, referencat duhet të interpretohen për të nënkuptuar legjislacionin pasardhës, dhe sipas rastit, dispozitat analoge në të.

KREU II DETYRAT DHE KOMPETENCAT E AGJENCISË

Neni 5 Ndërmarrjet dhe asetet nën autoritetin administrativ të Agjencisë

1. Agjencia ka kompetenca ekskluzive që të administrojë:

1.1. ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo;

1.2. të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas 22 Marsit 1989, përveç rasteve të rregulluara sipas paragrafi 2. të këtij neni; dhe

1.3. të gjitha aksionet në korporata dhe korporatat vartëse të themeluara sipas këtij ligji; dhe të gjithë interesat në pronësi shtetërore në një ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik, pavarësisht nëse ajo ndërmarrje apo subjekt juridik i është nënshtruar transformimit.

2. Nëse një rregullore ose ligj që është në fuqi dhe që është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë pas 10 Qershorit 1999 i cakton përgjegjësinë për administrimin e aseteve të përcaktuara në nën-paragrafi 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni një organi tjetër publik, Agjencia nuk do të ketë autoritet mbi këto ndërmarrje duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të atij ligji ose rregullore.

3. Autoriteti administrativ i Agjencisë i paraparë në nenin 5 paragrafi 1.1. do të vlejë për të gjitha pronat në pronësi apo posedim të ndërmarrjes, përfshirë pronat që gjenden jashtë Kosovës; me kusht që - dhe pavarësisht nga detyrimet e Agjencisë të përcaktuara në nenin 2 paragrafi 1 - lidhur me ato prona që gjenden jashtë Kosovës, Agjencisë i kërkohet vetëm të ushtrojë autoritetin e vet mbi ato prona deri në masën që Agjencia e konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën dhe qasjen ndaj këtyre pronave dhe kufizimet e burimeve administrative të Agjencisë siç referohen në nenin 7.1. të këtij ligji. Gjatë vendimmarrjes mbi këto çështje, Agjencia merr parasysh të gjitha politikat përkatëse të cilat mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës.

4. Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, ky transformim nuk do të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni si dhe neneve 6, 8 ose 9 të këtij ligji, përveç nëse:

4.1. transformimi është bazuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin në bazë të cilit është bërë transformimi;

4.2. janë përmbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me Transformimin, qofshin ato që kanë dalë gjatë apo pas Transformimit, qofshin ato të shqiptuara në bazë të ligjit apo ndonjë kontrate – përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, përmbushjen e plotë të detyrimeve që kërkojnë pagesën e kompensimit të plotë dhe lëshimin e aksioneve; dhe

4.3. transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5. Gjatë ushtrimit të të drejtave dhe kompetencave të saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji në lidhje me një ndërmarrje e cila i është nënshtruar transformimit, Agjencia ka të drejtë të supozojë se transformimi nuk i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni, përveç nëse Agjencia ka në dispozicion prova bindëse të gatshme të cilat vërtetojnë se transformimi i përmbush këto kushte. Në raste të këtilla zbatohet paragrafi 6. të këtij neni.

6. Nëse, në përputhje me paragrafin 5. të këtij neni, Agjencia konstaton se Transformimi i një ndërmarrje ose aseti i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 4, dhe Agjencia nuk

ka ndërmarrë ndonjë veprim më parë sa i përket ndërmarrjes së tillë apo ndonjë aset të saj sipas nenit 6.2. të këtij ligji, zbatohen rregullat në vijim:

6.1. nëse Agjencia ka prova të qarta të gatshme në dispozicion, të cilat në mënyrë bindëse e bëjnë ndarjen e të drejtave (ose pronësisë) të aksionarëve mbi ndërmarrjen, ndërmjet kapitalit shoqëror (ose pronësisë) dhe kapitalit privat (ose pronësisë), Agjencia do ta ndërpresë ushtrimin e autoritetit mbi këtë ndërmarrje përveç për qëllime të ushtrimit të të gjitha të drejtave të aksionarit (ose pronësisë) që dalin nga kapitali në pronësi shoqërore (pronësi) mbi një pjesë të kapitalit të përgjithshëm të ndërmarrjes, që përfshinë të drejtën për të shitur ato të drejta të aksionarit (pronësisë); dhe

6.2. në mungesë të këtyre provave, për ato ndërmarrje Agjencia do të vazhdojë të ushtrojë të drejtat dhe kompetencat e saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji.

7. Të gjitha çështjet që ndërlidhen me apo që shfaqen në lidhje me likuidimin e një ndërmarrje apo korporate nën autoritet të Agjencisë sipas nenit 6, paragrafi 2.1. të këtij ligji, përfshirë, mes tjerash, përcaktimin e vlefshmërisë së çdo pretendimi të bërë nga një kreditor i supozuar apo çdo pohim për barazi në interesat e pronësisë i bërë nga një pronar i supozuar dhe përcaktimin e shpërndarjes së duhur së të ardhurave të kreditorëve dhe pronarëve, janë përgjegjësi të autoritetit përkatës të likuidimit, i cili respekton rregullat e përcaktuara në Shtojcën e këtij ligji. Çdo person që parashton një pretendim apo pohon një interes të tillë i cili nuk pajtohet me përcaktimin e autoritetit të likuidimit që prekë atë pretendim apo interes të pohuar, ka të drejtën që t'i sfidojë ato përcaktime pranë Dhomës së Posaçme duke iu përmbajtur kërkesave procedurale të parapara në nenin 37.7 të Shtojcës së këtij ligji.

Neni 6

Fushëveprimi i kompetencave administrative të Agjencisë

1. Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. Ky autoritet përfshinë çdo veprim që Agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur, brenda kufijve të burimeve administrative të Agjencisë, për të mundësuar më mirë shitjen, likuidimin, transferimin apo ndonjë zgjidhje tjetër të ndërmarrjes, asetit apo interesit në pronësi shtetërore. Pa paragjykim ndaj përgjithësimin në fjalinë e mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që sa i përket ndërmarrjeve, ai autoritet të përfshijë të gjitha veprimet të cilat Agjencia i konsideron të arsyeshme dhe të duhura për ruajtjen ose rritjen e vlerës, shanseve për sukses ose qeverisjes së ndërmarrjes, duke përfshirë:

1.1. emërimin dhe zëvendësimin e kryesuesit, drejtorëve dhe menaxherëve të ndërmarrjes;

1.2. themelimin, konfirmimin ose riformimin e bordit mbikëqyrës, bordit menaxhues, këshillit të punëtorëve ose organit tjetër menaxhues apo mbikëqyrës të ndërmarrjes;

1.3. ndryshimin e kompetencave të cilitdo person ose organ të përmendur në paragrafin 1.1 ose 1.2 të këtij paragrafi;

1.4. nxjerrjen e udhëzimeve lidhur me veprimtarinë e ndërmarrjes, në veçanti lidhur me

politikat për menaxhim të shëndoshë financiar;

1.5. marrjen përsipër të kontrollit të drejtpërdrejtë mbi ndërmarrjen, duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, dhe administrimin e këtyre llogarive dhe asetëve veçmas nga llogaritë e Agjencisë;

1.6. auditimin e jashtëm të ndërmarrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes agjentëve të autorizuar;

1.7. kërkesën nga çdo nëpunës, kontraktues ose ndërmjetësues tjetër afarist të ndërmarrjes, që të ofrojë informacionet që i posedon për ndërmarrjen e tillë;

1.8. kërkesën nga çdo person që ka kontroll mbi dokumentet e ndërmarrjes që të mundësojë qasje në këto dokumente për shqyrtim, kopjim dhe ruajtje;

1.9. hyrjen dhe inspektimin e lokaleve të ndërmarrjes;

1.10. aprovimin e planeve të biznesit dhe planeve të investimit të ndërmarrjes;

1.11. nxjerrjen ose ndryshimin e akteve të themelimit, akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera përkatëse të ndërmarrjes;

1.12. regjistrimin e ndërmarrjeve në Kosovë, për ato që nuk janë regjistruar në mënyrë adekuate;

1.13. arritjen e marrëveshjeve për menaxhimin, rindërtimin ose riorganizimin e ndërmarrjeve;

1.14. dhënien e koncesioneve ose kontratave të qirasë që lidhen me ndërmarrjet;

1.15. themelimin dhe regjistrimin, në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe nenin 8 paragrafi 1. dhe 8. paragrafi 2. të këtij ligji të një apo më shumë korporatave ndihmëse të ndërmarrjeve që janë në pronësi të atyre ndërmarrjeve, por që administrohen nga Agjencia, dhe transferimin e një pjese apo tërë asetëve të ndërmarrjeve në këto korporata ndihmëse;

1.16. transformimin e ndërmarrjeve në korporata dhe themelimin dhe regjistrimin e korporatave të tilla në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare;

1.17. ristrukturimin e ndërmarrjes në disa korporata dhe transferimin e asetëve të asaj ndërmarrje në ato korporata dhe themelimin dhe regjistrimin e korporatave të tilla në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare;

1.18. dhënien me kontratë të një pjese të veprimtarisë së ndërmarrjes; dhe

1.19. inicimin sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, të procedurës së mbikëqyrur nga gjykata të riorganizimit ose likuidimit të ndërmarrjes dhe marrjen pjesë në ato procedura në cilësinë dhe mënyrën e paraparë në atë rregullore.

2. Në lidhje me Ndërmarrjet, Agjencia, përveç kompetencave nga neni 6.1, është e autorizuar që të ndërmerr veprimet në vijim të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme:

2.1. shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera, në pajtim me kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, të një pjese apo tërë asetëve të ndërmarrjes në këto korporata apo në korporatat ndihmëse të referuara në nenin 6 nën-paragrafët 1.15, 1.16. dhe 1.17;

2.2. likuidimin e ndërmarrjeve apo korporatave të referuara në nenin 6.1 në pajtim me nenin 9 dhe Shtojcën e këtij ligji; apo

2.3. të shesë transferojë apo disponojë në ndonjë mënyrë tjetër çdo aset në kompetencat administrative të Agjencisë.

3. Ligji Nr. 03/L-212 mbi “Ligjin Themelor të Punës” nuk do të zbatohet në lidhje me ndonjë veprim të ndërmarrë nga Agjencia nën autoritetin e këtij neni 6; sidoqoftë me kusht që neni 76.7 i atij ligji të përdoret për të përcaktuar shumën e pagesës për shkurtim nga puna që mundet të ngrihet si pretendim i vlefshëm sipas nenit 40 të shtojcës.

Neni 6/A

Kompensimi për pronat e shpronësuara të Ndërmarrjeve Shoqërore

1. Pavarësisht nga neni 11 paragrafi 8 si dhe neni 26 paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Qeveria e Kosovës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike merr për obligim që lidhur me shpronësimet e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore nga vlera e përgjithshme e shpronësimit, t'i kompensoj Agjencisë shumat si në vijim:

1.1. Njêzet përqind (20%) e vlerës së pronës së shpronësuar, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjeve Shoqërore në pajtim me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/45.

2. Vendimi për transferin pronësor të pronës së shpronësuar në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës merret nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, pasi të plotësohen obligimet financiare të Qeverisë të përcaktuara sipas nënparagrafit 1.1. të këtij neni.

3. Në rast se fondi në mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme apo për mbulimin e shpenzimeve të parapara në paragrafët 1.1 deri 1.3 të nenit 40 të shtojcës së ligjit bazik, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë dhe Qeveria, respektivisht Ministria e Financave brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike ia transferon Agjencisë shumën e nevojshme për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit apo për mbulimin e shpenzimeve të parapara në paragrafët 1.1 deri 1.3 të nenit 40 të shtojcës së ligjit bazik, por jo më shumë se sa vlera e pronës së shpronësuar.

4. Në rast se ka fonde të mbetura nga vlera e përgjithshme e shpronësimit pas përmbushjes së të

gjitha detyrimeve sipas këtij neni, atëherë ato fonde do të trajtohen në pajtim me nenin 4, paragrafin 3 të këtij ligji.

5. Ky nen vlen për shpronësimet e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore që kanë filluar dhe janë në procedurë të kompensimit dhe për pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore në të ardhmen.

Neni 7 **Ushtrimi i kompetencave**

1. Përveç nëse Bordi nuk vendos ndryshe, Agjencia përmbush detyrat e parapara sipas këtij kapitulli, duke ushtruar mbikëqyrjen e menaxhimit të përgjithshëm mbi ndërmarrjet dhe korporatat, brenda kufijve të burimeve të veta administrative.

2. Përveç nëse Bordi nuk vendos ndryshe, veprimtaria e përditshme afariste e ndërmarrjeve drejtohet nga organet menaxhuese dhe organet e tjera të ndërmarrjes, pa paragjykuar kompetencat e Agjencisë sipas këtij ligji.

Neni 8 **Themelimi i korporatave; shitja e aksioneve**

1. Siç parashihet në nenin 6, paragrafi 1.16. dhe 1.17. Agjencia mund ta transformojë apo ristrukturojë një ndërmarrje në një apo më tepër korporata. Nëse Agjencia ndërmerr masa të tilla aksionet e korporatës(ave) fillimisht regjistrohen në emër të Republikës së Kosovës, dhe Agjencia sipas këtij ligji ka kompetenca që të ushtrojë të gjitha të drejtat pjesëmarrëse të aksionarit për Republikën e Kosovës përfshirë kompetencën për ta shitur, transferuar apo zgjidhur në mënyra tjera aksionet sipas nenit 6, paragrafi 2.1. Agjencia gjithashtu ka kompetenca që ta bëjë likuidimin e një korporate të tilla sipas asaj që është paraparë në nenin 6, paragrafi 2.2. Të ardhurat që dalin nga çdo veprim i tillë mbahen në mirëbesim për përmbushjen e kërkesave të kreditorëve dhe pronarëve të ndërmarrjes dhe i nënshtrohen dispozitave të zbatueshme të këtij ligji dhe shtojcës që rregullon shpërndarjen e të ardhurave.

2. Siç parashihet në nenin 6 paragrafi 1.15, Agjencia mund të themelojë në emër të ndërmarrjes një apo më shumë korporata ndihmëse dhe t'u transferojë këtyre korporatave të drejtat dhe interesat në asetet e ndërmarrjes, pjesërisht ose plotësisht. Agjencia vendos për secilin rast veç e veç nëse dhe në ç'masë korporata ose korporatat e themeluara në këtë mënyrë do t'i marrin përsipër detyrimet e ndërmarrjes përkatëse. Aksionet e korporatës ose korporatave të themeluara në këtë mënyrë do të administrohen nga Agjencia në pajtim me këtë ligj. Nëse një kreditor paraqet pretendim mbi një detyrim ose përgjegjësi e cila, sipas vendimit të Agjencisë të përmendur në këtë paragraf, është marrë përsipër nga një Korporatë, Kreditori nuk do të ketë të drejtë të shpërndajë asnjë të ardhur që ka dalë nga shitja e aksioneve të Korporatës apo shita e ndonjë asemi (përveç nëse kreditori ka dokumentuar në mënyrë të kënaqshme se ka interes hipotekar); Në raste të tilla kreditori do të ketë mundësi ekskluzive që të parashtojë ankesë/prendim kundër korporatës.

3. Agjencia në bazë të këtij ligji ka kompetenca për të ushtruar të gjitha të drejtat e aksionarit mbi ndërmarrjen që është pronare e aksioneve të Korporatës ndihmëse të themeluar në bazë të neneve 6 paragrafi 1.15 dhe nenit 8 paragrafi 2, përfshirë të drejtën për të shitur, transferuar apo zgjidhur

një pjesë apo të gjitha aksionet në emër të asajë ndërmarrje. Të ardhurat eventuale që dalin nga kjo, grumbullohen në ndërmarrjen që ka qenë pronare e aksioneve.

4. Agjencia mbanë, administron dhe shpërndanë ndonjë apo të gjitha të ardhurat që dalin nga shitja, transferimi apo zgjidhja e aksioneve në Korporatë apo Korporatë ndihmëse në pajtim me dispozitat në fuqi të këtij ligji dhe Shtojcën.

5. Çdo shitje, transferim apo zgjidhje në mënyrë tjetër e aksioneve në Korporatë apo Korporatën ndihmëse sipas nenit 6. paragrafi 2.1 dhe këtij neni 8 do të bëhet vetëm pas një procedure të hapur dhe konkurruese të tenderimit.

6. Pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e këtij ligji, nëse Agjencia e ushtron të drejtën e kontratës për të rifituar apo anuluar aksionet e Korporatës ndihmëse që është shitur më parë nga Agjencia apo paraardhësi i saj, Agjencia mund të ndërmarrë cilëndo nga veprimet e specifikuar në nenin 6 paragrafi 2.2. sa i përket korporatës ndihmëse ose disave apo të gjitha aseteve të saj. Në rastin e tillë:

6.1. palët tjera në kontratë kanë vetëm ato të drejta që mund të parashihen në mënyrë specifike në kontratën në fjalë;

6.2. të gjitha fondet e pranuar nga Agjencia si pasojë e një veprimi të tillë – minus tarifa administrative prej pesë përqind (5%) neto e Agjencisë sipas nenit 21, paragrafi 2. të këtij ligji dhe shpenzimet e dokumentuara të Agjencisë të dala nga ushtrimi i asaj të drejte kontraktuese dhe për ndërmarrjen e veprimeve të tilla – do të përdoren për të përmbushur kërkesat e kreditorëve të Korporatës së tillë ndihmëse; dhe

6.3. nëse pas përmbushjes së të drejtave kontraktuale të palëve tjera që dalin nga kontrata dhe kreditorëve të Korporatës mbetet ndonjë pjesë e fondeve të tilla, ato fonde të mbetura do të përfshihen në të ardhurat që do të përdoren për të përmbushur pretendimet e kreditorëve dhe pronarëve të ndërmarrjes që fillimisht i ka mbajtur ato asete të cilat i janë transferuar Korporatës ndihmëse kur ajo është themeluar.

Neni 9

Likuidimi i kryer nga Agjencia

1. Bordi mund të iniciojë likuidimin e një ndërmarrje, korporate, aseti ose një pjese të saj, përmes lëshimit të Vendimit për Likuidim nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve ose pronarëve përkatës. Procesi i likuidimit do të ushtrohet në bazë të procedurave të përcaktuara të parapara në Shtojcën e këtij ligji.

2. Të gjitha kompetencat e organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjes ose korporatës që i nënshtrohet Vendimit të likuidimit, i dorëzohen autoritetit përkatës të likuidimit të themeluar në bazë të Shtojcës së këtij ligji.

3. Secili autoritet i likuidimit është pjesë integrale e Agjencisë. Të gjitha veprimet apo mosveprimet e autoritetit të likuidimit janë veprime dhe mosveprime të Agjencisë. Secili person

që punon, apo është i angazhuar apo i emëruar të ndihmojë autoritetin e likuidimit është “person i punësuar apo angazhuar nga Agjencia” sipas kuptimit të nenit 18.5 të këtij ligji.

Neni 10 **Politika operative**

1. Bordi nxjerr politikën operative për udhëheqjen e Agjencisë në ushtrimin e kompetencave të saj, sipas këtij kapitulli, me qëllim të:

1.1. sigurimit të pajtueshmërisë me detyrat e Agjencisë sipas këtij ligji dhe elementeve tjera të zbatueshme të së drejtës në Kosovë; dhe

1.2. në kuadër të burimeve administrative në dispozicion të Agjencisë, të promovojë marrjen e masave të arsyeshme për ruajtjen dhe rritjen e vlerës, shansit për sukses dhe qeverisjes së ndërmarrjeve;

2. Përkitazi me ushtrimin e kompetencave të Agjencisë sipas nenit 6 paragrafi 2., politikat operative ndër të tjera:

2.1. në përgjithësi vendosin rregulla dhe procedura që sigurojnë që veprimet e ndërmarra nga Agjencia janë në pajtim me kriteret e nenit 2 paragrafi 3. të këtij ligji;

2.2. për veprimet e ndërmarra sipas nenit 6 paragrafit 2.1. caktojnë rregulla transparente dhe të njëtrajtshme lidhur me procesin e ofertimit të përmendur në nenin 8 paragrafi 5. që sigurojnë konkurrencë të drejtë ndërmjet ofertuesve, dhe janë në mënyrë të arsyeshme të orientuar drejt fitimit të vlerës së drejtë të tregut për aksionet; dhe

2.3. sigurojnë që ato rregulla dhe procedura të vendosen në dispozicion të publikut;

3. Politikat operative përfshijnë procedura për njoftimin e publikut mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia, sipas:

3.1. nenit 6 paragrafi 1.14. kur këto koncesione apo kontrata qiradhënieje kanë të bëjnë me një pjesë të konsiderueshme të veprimtarive më të rëndësishme të ndërmarrjes, ashtu siç është përcaktuar në politikat operative;

3.2. nenit 6. paragrafi 1.16, 1.17 dhe 1.19 dhe 6 paragrafi 2.1;

3.3. nenit 6 paragraf 2.2 me kusht që ato procedura të janë në pajtim me nenin 49 të Shtojcës së këtij ligji; dhe

3.4. nenit 6 paragrafi 2.3. kur transaksioni në fjalë përfshinë një apo më tepër asete që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të gjithë asetëve të ndërmarrjes, siç është përcaktuar në politikat operative dhe procedurat e tilla janë në pajtim me nenin 49 të Shtojcës.

4. Politikat operative vendosin standarde për qeverisje të mirë të korporatave, të cilat Agjencia ua

imponon ndërmarrjeve në një masë të realizueshme. Në veçanti këto standarde duhet:

4.1. të promovojnë respektimin e kërkesave të raportimit financiar dhe kërkesave të auditimit të jashtëm të parapara me të drejtën e Kosovës;

4.2. të sigurojnë mbrojtje kundër keqpërdorimit të kompetencave menaxhuese, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përdorimin e informacioneve konfidenciale për përfitim personal, shitjen veçmas të aseteve të ndërmarrjes me qëllim fitimi personal dhe përvetësimin e fitimit.

KREU III ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

Neni 11 Struktura organizative

1. Agjencia ka Bordin e Drejtorëve, Drejtorin Menaxhues dhe dy Zëvendësdrejtorë Menaxhues, Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive si dhe personelin profesional dhe teknik.
2. Bordi i bartë të gjitha kompetencat e Agjencisë. Bordi mund t’ia delegojë ushtrimin e kompetencave të veta Drejtorit Menaxhues, përveç kompetencave të rezervuara për Bordin sipas nenit 15.
3. Drejtori Menaxhues është kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë. Drejtori Menaxhues dhe dy Zëvendësdrejtorët Menaxhues emërohen dhe shkarkohen nga Bordi. Ata ushtrojnë kompetencat e Agjencisë të cilat u janë dhënë atyre nga Bordi ose nga ky ligj.
4. Drejtori Menaxhues, nën kontrollin e përgjithshëm të Bordit, drejton veprimtarinë e zakonshme të Agjencisë. Drejtori Menaxhues është përgjegjës për organizimin, emërimin dhe shkarkimin e personelit, përveç për emërimin dhe shkarkimin e dy Zëvendësdrejtorëve Menaxhues dhe personelit tjetër që mund të caktohet nga Bordi. Drejtori Menaxhues ushtron kompetencat tjera që mund t’i delegohen nga Bordi.
5. Sekretaria Ekzekutive do t’i sigurojë Bordit të gjitha informatat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe mbajtjen e takimeve të Bordit, si dhe do të ushtrojë të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në akte nënligjore.
6. Struktura e përgjithshme organizative dhe kompensimi i personelit të Agjencisë rregullohet sipas ligjit bazik dhe rregulloreve të nxjerra nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 12 Përbërja e Bordit

- ~~1. Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë.~~

~~2. Kuvendi i Kosovës do të emërojë pesë (5) Drejtorë, duke përfshirë një përfaqësues nga një komunitet jo Shqiptar si dhe përfaqësuesin e sindikatave të punëtorëve, dhe të caktojë njërin nga të emëruarit që të shërbejë si Kryesues i Bordit.~~

~~3. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar emëron tre ndërkombëtarë si Drejtorë të Bordit. Pas pëlqimit nga PCN, Bordi do të emërojë një qytetarë të Kosovës si Drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit; ky person nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi po ashtu do të emërojë njërin nga anëtarët e tij, përveç Kryesuesit, që të shërbejë si Zëvendës Kryesues. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e termave të referencës të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve, duke përfshirë votën afirmative të secilit prej drejtorëve ndërkombëtar.~~

~~3. Kuvendi pas propozimit nga qeveria zgjedh tre (3) anëtarë ndërkombëtarë drejtorë të bordit. Bordi, po ashtu, emëron një shtetas të Kosovës drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Bordi, përveç kryesuesit, po ashtu, emëron zëvendëskryesues njërin prej anëtarëve të tij. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit të Drejtorëve. Anëtarët ndërkombëtarë zgjedhën më mandat deri më 31 gusht 2014.~~

~~4. Drejtori menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorët menaxhues nuk janë anëtar të Bordit.~~

~~5. Drejtorët shërbejnë në Bord në cilësi personale dhe marrin pjesë personalisht në takimet e Bordit.~~

~~6. Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet Drejtor nëse:~~

~~6.1. është dënuar për kryerje të ndonjë vepre penale që ngërthen elemente të mashtrimit, pas një procedure përkatëse dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Kosovare;~~

~~6.2. është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për shkak të shkeljeve të rënda profesionale pas një procedure përkatëse dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare;~~

~~6.3. ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo kundër një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim; dhe~~

~~6.4. ka interesa ose angazhohet në veprimtari të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15 të këtij ligji.~~

~~7. Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si Drejtor, personi duhet të ketë së paku pesë vite përvojë pune në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa, menaxhim të ndërmarrjeve, punë rregullatore ose përvojë tjetër përkatëse.~~

~~8. Drejtorët mund të delegohen në Agjenci nga institucione tjera. Në këto raste, kompensimi i tyre, nëse ka kompensim, dhe kushtet e tyre të shërbimit varen nga kontrata e tyre me institucionin eaktues. Privilegjet dhe imuniteti i Drejtorëve të deleguar, nëse ka të këtillë, varen nga privilegjet~~

~~dhe imuniteti i institucionit caktues dhe marrëdhënia kontraktuese e Drejtorit me institucionin përkatës. Ky rregull zbatohet po ashtu sa i përket obligimeve tatimore të Drejtorëve të deleguar në Kosovë.~~

Neni 12 **Përbërja e Bordit**

1. Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë.
2. ~~Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë, emëron Drejtorët e Bordit, duke përfshirë një përfaqësues nga komunitetet joshumicë si dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve.~~
3. ~~Kuvendi, me propozimin e Qeverisë, nga radhët e anëtarëve të Bordit cakton Kryesuesin e Bordit.~~
4. Bordi, emëron zëvendëskryesues të Bordit, njërin prej anëtarëve të tij.
5. Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet Drejtor nëse:
 - 5.1. është dënuar për kryerje të ndonjë vepre penale;
 - 5.2. është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për
 - 5.3. shkak të shkeljeve të rënda profesionale në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 5.4. ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo kundër një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim; dhe
 - 5.5. ka interesa ose angazhohet në veprimtari të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15 të këtij ligji.
6. ~~Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si Drejtor, personi duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa dhe punë menaxheriale.~~
7. ~~Bordi emëron Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit.~~
8. ~~Drejtori menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorët menaxhues nuk janë anëtar të Bordit.~~

Neni 12 **Përbërja e Bordit**

1. Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë.
2. Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, emëron Drejtorët e

Bordit, duke përfshirë një përfaqësues nga komunitetet jo shumicë si dhe një përfaqësues nga konfederata sindikale e punëtorëve.

3. Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nga radhët e anëtarëve të Bordit cakton Kryesuesin e Bordit.

4. Bordi emëron për zëvendës kryesues të Bordit, njërin prej anëtarëve të tij.

5. Drejtorët shërbejnë në Bord në cilësi personale dhe marrin pjesë personalisht në takimet e Bordit.

6. Asnjë person nuk mund të emërohet ose të mbetet Drejtor nëse:

6.1. është dënuar për kryerje të ndonjë vepre penale;

6.2. është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për shkak të shkeljeve të rënda profesionale në pajtim me legjislacionin në fuqi;

6.3. ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo kundër një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim; dhe

6.4. ka interesa ose angazhohet në veprimtari të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15 të ligjit bazik.

7. Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si Drejtor, personi duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në njërën nga fushat në vijim: administratë publike, drejtësi, financa, ekonomi si dhe punë menaxheriale.

8. Bordi emëron Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohen së paku pesë (5) vota pozitive të Bordit.

9. Drejtori menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorët menaxhues nuk janë anëtarë të Bordit.

Neni 13

Mandati dhe Detyrat e Drejtorëve

~~1. Kryesuesi, Zëvendëskryesuesi dhe Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit emërohen për një mandat tre (3) vjeçar dhe të tjerët për një mandat dy (2) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.~~

1. Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe drejtorët tjerë të Bordit emërohen me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, emërohet me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ky paragraf zbatohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Drejtorët do t'i kryejnë detyrimet e tyre në mënyrë të paanshme duke synuar për përmbushjen e

qëllimeve të Agjencisë të përcaktuara në nenin 2. Ata nuk duhet të pranojnë udhëzime lidhur me ushtrimin e detyrave të tyre.

3. Drejtorët kanë ndaj Agjencisë detyrimin e njëjtë për mirëbesim sikurse Drejtorët e Shoqërive Aksionare sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

4. Drejtorët mund të shkarkohen nga detyra nga subjekti i cili i ka emëruar nëse ata:

4.1. e humbin të drejtën për të shërbyer si Drejtor sipas nenit 12.6 të këtij ligji;

4.2. e shfrytëzojnë postin për përfitime personale apo në dobi të ndonjë personi apo subjekti tjetër përveç Agjencisë;

4.3. bëhen të paafte për kryerjen e detyrave të tyre së paku për një periudhë tre (3) mujore;

4.4. nuk pajtohen me ndonjë vendim të marrë sipas nenit 5 të këtij ligji; ose

4.5. i shkelin detyrat e tyre.

Neni 14 **Procedurat e Bordit**

1. Procedurat e Bordit do të caktohen në aktet nënligjore të Agjencisë të miratuara nga Bordi.

2. Mbledhjet e rregullta të Bordit do të konvokohen së paku një herë në muaj. Kryesuesi mund të thërrasë mbledhje të tjera në çdo kohë dhe këtë e bën me kërkesën e së paku dy drejtorëve.

3. Dy donatorët më të mëdhenj ndërkombëtarë të Agjencisë do të kenë të drejtën e pjesëmarrjes në të gjitha mbledhjet e Bordit në cilësinë e vëzhguesve pa të drejtë vote.

~~4. Bordi konsiderohet se ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku pesë drejtorë, së paku njëri ndër të cilët duhet të jetë Drejtor ndërkombëtar.~~

4. Bordi ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku pesë (5) drejtorë.

5. Vendimet e Bordit do të merren me konsensus dhe nëse konsensusi nuk mund të arrihet, me votim.

6. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, nëse nuk është paraparë ndryshe në këtë ligj ose në aktet nënligjore të Agjencisë.

[paragrafi 7 ka vlejtur deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtar të Bordit më 31 Gusht 2014.]

~~7. Kur, për një vendim të caktuar, sipas këtij ligji ose rregulloreve të Agjencisë nevojitet shumica e kualifikuar, vendimi do të merret me së paku pesë (5) vota pozitive. Të gjitha vendimet mbi pagesat të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15 paragrafi 2.7. duhet të marrin votën pozitive të tre~~

~~Drejtorëve Ndërkombëtarë.~~

~~7. Për vendimet të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15, nevojitet shumica e kualifikuar, vendimi do të merret me së paku pesë (5) vota pro.~~

7. Për vendimet të cilat duhet të merren sipas nenit 15 nevojitet shumica e kualifikuar, vendimi do të merret me së paku pesë (5) vota pozitive. Bordi i Drejtorëve mund të përcaktoj me rregullore të veçantë se cilat vendime tjera të Bordit sipas ligjit bazik do të merren me shumicë të kualifikuar.

8. Çdo drejtor ka nga një votë. Në rast të ndarjes së barabartë të votave, vota e Kryesuesit është vendimtare për çështjen në fjalë.

[paragrafi 9 ka vlejtur deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtar të Bordit më 31 Gusht 2014.]

~~9. Pavarësisht nga nenet 14 paragrafi 6. dhe 7, tre anëtarët ndërkombëtarë të Bordit në mënyrë të përbashkët dhe unanime mund të pezullojnë cilindo vendim të marrë nga Bordi, nëse vendosin se vendimi është në kundërshtim me parimet e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke përfshirë të gjitha Protokollat e kësaj konvente ose të drejtën e zbatueshme, dhe duhet ta paraqesin çështjen për vendim nga Dhoma e Posaçme. Dhoma e Posaçme i merr këto vendime në mënyrë urgjente. Vendimi i sipër cekur i Bordit mbetet i pezulluar deri në marrjen e vendimit nga Dhoma e Posaçme.~~

10. Aktet nënligjore mund t'i përcaktojnë vendimet që mund të merren vetëm nga kryesuesi (apo zëvendësi i tij). Në raste emergjente kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi, duke vepruar së bashku, mund të marrin vendime të cilat më pas i nënshtrohen konfirmimit nga Bordi në mbledhjen e ardhshme të tij.

11. Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit ka detyrat e përcaktuara në akte nënligjore.

Neni 15 Përgjegjësitë e Bordit

1. Bordi ka përgjegjësi të përgjithshme për aktivitetet e Agjencisë dhe për përmbushjen e kësaj përgjegjësie ndërmerr veprimet e duhura apo të lejuara me këtë ligj.

2. Vendimet e poshtëshënuara të Bordit do të merren me shumicën e kualifikuar dhe nuk mund t'i delegohen asnjë personi:

2.1. miratimi i aktit të themelimit, rregulloreve, strukturës së përgjithshme organizative, politikës financiare dhe të auditimit, shpërblimit, politikës së personelit dhe punësimit të Agjencisë;

2.2. miratimi i politikës operative sipas nenit 10 të këtij ligji;

~~2.3. emërimi apo shkarkimi i një zëvendës drejtori menaxhues ose ndonjë zyrtari tjetër, emërimi i të cilëve është rezervuar për Bordin;~~

~~2.3. emërimi apo shkarkimi i Drejtorit Menaxhues, Zëvendësdrejtorit Menaxhues ose të ndonjë zyrtari tjetër.~~

2.3. emërimi apo shkarkimi i Drejtorit Menaxhues, Zëvendësdrejtorit Menaxhues ose ndonjë zyrtari tjetër, emërimi i të cilëve është rezervuar për Bordin;

2.4. konstituimi, konfirmimi ose përbërja e Bordit mbikëqyrës, këshillit të punëtorëve ose organit tjetër mbikëqyrës të ndërmarrjes dhe çdo përcaktim apo ndryshim i kompetencave dhe përgjegjësive të organit të tillë;

2.5. vendosja e një ndërmarrje nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë sipas nenit 6 paragrafi 1.5. të këtij ligji;

2.6. miratimi apo ndryshimi i aktit të themelimit, akteve nënligjore ose dokumenteve të ngjashme të një ndërmarrje;

2.7. vendimi për pagesat të cilat duhet të bëhen nga të ardhurat që rezultojnë nga aktivitetet e Agjencisë sipas neneve 8 dhe 9 të këtij ligji ose që mbahen në mirëbesim në të mirë të Kreditorëve ose Pronarëve, përveç nëse Dhoma e Posaçme paraprakisht ka nxjerrë një vendim i cili duhet të zbatohet menjëherë dhe i cili kërkon bërjen e këtyre pagesave;

2.8. nënshkrimi i një marrëveshje për menaxhimin, rindërtimin ose riorganizimin e ndërmarrjes ose një marrëveshje për qiradhënie lidhur me ndonjë ndërmarrje në pajtim me nenin 6 paragrafi 1.13. të këtij ligji;

2.9. dhënia e koncesioneve ose qiradhënia e pronës, të drejtave ose veprimtarive të ndërmarrjes sipas nenit 6 paragrafi 1. 14. të këtij ligji;

2.10. miratimi i planeve për riorganizimin ose ristrukturimin e ndërmarrjes;

2.11. miratimi i krijimit të një ose më shumë korporatave sipas nenit 8 të këtij ligji;

~~2.12. shitja ose transferi i një pjese ose i të gjitha aksioneve të një korporate të krijuar sipas nën-paragrafit 2.11. të këtij paragrafi një-pale të jashtme;~~

2.12. shitja ose transferi i një pjese ose i të gjitha aksioneve të një korporate të krijuar sipas nenit 8 të ligjit bazik si dhe shitja e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë vendosur në likuidim sipas nenit 9 të ligjit bazik;

2.13. marrjen e vendimit për Likuidimin;

2.14. vendimi për fillimin e procedurës së riorganizimit ose likuidimit të një Ndërmarrje në përputhje me Rregulloren për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve;

2.15. miratimi i buxhetit dhe i planeve të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm kalendarik;

2.16. miratimi i punës (performancës) së menaxhmentit në bazë të raportit vjetor të auditimit;

2.17. vendimi nëse një ndërmarrje e veçantë ose një grup i caktuar i ndërmarrjeve do të konsiderohet nga Agjencia se i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 5; dhe

2.18. vendosja e procedurave, funksioneve ose njësive të kontrollit të brendshëm në Agjenci të cilat Bordi i konsideron të nevojshme.

3. Agjencia merr vendimet për privatizimin ose likuidimin e ndërmarrjeve vetëm pas konsultimit me zyrtaret e komunave në të cilat ndodhet ndërmarrja përkatëse.

Neni 16 **Menaxhmenti dhe personeli**

1. Drejtori Menaxhues me ndihmën e dy Zëvendës drejtorëve menaxhues është përgjegjës për:

1.1. kryerjen e të gjitha funksioneve që i janë deleguar atij nga Bordi;

1.2. zhvillimin e veprimtarisë së rregullt të Agjencisë në pajtim me politikën dhe udhëzimet që mund të nxirren nga Bordi;

1.3. organizimin, emërimin dhe largimin nga puna të personelit (përveç Zëvendës drejtorëve menaxhues dhe zyrtarëve të tjerë, emërimin e të cilëve Bordi e ka rezervuar për vete) në pajtim me vendimet e marra ose udhëzimet e nxjerra nga Bordi;

1.4. përgatitjen e mbledhjeve të Bordit dhe sigurimin e zbatimit të vendimeve të Bordit; dhe

1.5. kryerjen e çfarëdo funksioni në marrëveshje me Bordin në pajtim me nenin 2 paragrafi 2.2. të këtij ligji.

2. Drejtori menaxhues i raporton Bordit dhe i përgjigjet vetëm atij dhe asnjë pale tjetër.

3. Drejtori menaxhues dhe dy Zëvendës drejtorët menaxhues emërohen nga Bordi. Kryesuesi është përgjegjës për nominimin e kandidatëve për këto pozita në pajtim me procedurat që do të përshihen në rregullore të miratuar nga Bordi dhe lëshuar nga Agjencia. Drejtori menaxhues dhe zëvendës drejtorët menaxhues në çdo kohë mund të shkarkohen nga Bordi. Bordi vendosë për kompensimin dhe kushtet e tjera të shërbimit të drejtorit dhe Zëvendës drejtorëve menaxhues, pa cenuar nenin 16 paragrafi 5 më poshtë. Drejtori Menaxhues apo njëri nga zëvendës drejtorët menaxhues të caktuar nga Drejtori Menaxhues janë të pranishëm në secilin takim të Bordit me qëllim të dhënies së këshillave dhe informatave për Bordin dhe të përgjigjes në pyetjet e parashtruara atyre nga anëtarët e Bordit. Kur Bordi diskuton çfarëdo çështje të interesit specifik personal për Drejtorin Menaxhues apo zëvendës drejtorin menaxhues i cili është i pranishëm, Kryesuesi mund të kërkojë që ai person të mos jetë i pranishëm gjatë bisedimeve. Drejtori Menaxhues dhe dy zëvendës drejtorët menaxhues nuk kanë të drejtë vote në takimet e Bordit.

4. Personat të cilët nuk kanë të drejtë për t'u emëruar për drejtorë të Bordit sipas nenit 13.4

gjithashtu nuk kanë të drejtë të emërohen për Drejtor Menaxhues ose Zëvendësdrejtor menaxhues. Ata gjithashtu nuk kanë të drejtë të zgjidhen në këto poste nëse mbajnë një post publik ose janë anëtarë të një organi ekzekutiv në një parti politike.

5. Menaxhmenti dhe personeli tjetër i Agjencisë mund të delegohen në Agjenci nga institucionet e tjera. Në rastet e tilla, kompensimi dhe kushtet e tyre të shërbimit do të varen nga kontrata e tyre me institucionin i cili i dërgon. Privilegjet dhe imuniteti i personelit të deleguar, nëse kanë të tilla, varen nga privilegjet dhe imunitetet e institucionit që i dërgon dhe nga marrëdhënia kontraktuese e personelit të transferuar me atë institucion. Ky rregull zbatohet po ashtu për tatimin e Drejtorëve të caktuar në Kosovë.

6. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, menaxhmenti dhe personeli i përgjigjen vetëm Agjencisë. Ata nuk duhet të marrin kurrfarë udhëzimesh sa i përket kryerjes së detyrave të tyre nga asnjë autoritet tjetër përveç Bordit ose nga eprori i tyre hierarkik në Agjenci.

7. Menaxhmenti dhe personeli duhet ta ruajnë fshehtësinë e informatave të fituara gjatë shërbimit të tyre në Agjenci, edhe gjatë edhe pas shërbimit të tyre në Agjenci.

8. Menaxhmenti dhe personeli nuk duhet të kenë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në një ndërmarrje apo në ndonjë palë e cila pretendon një interes në atë ndërmarrje. Menaxhmentit dhe personelit gjithashtu i ndalohet marrja e përfitimeve nga çdo palë tjetër përveç nga Agjencia për çdo veprim ose mosveprim të Agjencisë, pa cenuar nenin 16.5.

9. Menaxhmenti dhe personeli kanë ndaj Agjencisë detyrimin e njëjtë për mirëbesim, kujdes dhe dilijencë sikurse zyrtarët, menaxhmenti dhe personeli i shoqërive aksionare sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

10. Bordi, menaxhmenti dhe personeli nuk i përgjigjen asnjë pale tjetër për cilindo veprim ose mosveprim të bërë në emër të Agjencisë, përveç Agjencisë brenda kompetencave që u janë dhënë atyre nga Agjencia. Bordi, menaxhmenti dhe personeli janë përgjegjës ndaj Agjencisë për çdo mosrespektim të detyrave të tyre sipas këtij ligji ose sipas kontratave të tyre me Agjencinë, pa cenuar nenin 16.5.

KREU IV DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 17 Kapitali Themeltar

Agjencia do të ketë kapitalin themeltar në shumë prej dhjetë milionë (10.000.000) Euro, prej të cilave një milion (1.000.000) Euro do të paguhet me të holla të gatshme ose në natyrë; pjesa e mbetur mund të kërkohet nga Bordi në kohën dhe në shumën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë. Kapitali themeltar i Agjencisë mund të rritet nga Kuvendi i Kosovës me fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në përputhje me të drejtën në Kosovë, dhe nuk mund të reduktohet. As Republika e Kosovës dhe as Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk janë

përgjegjëse për detyrimet e Agjencisë.

Neni 18

Detyrimet dhe Përgjegjësitë e Agjencisë

1. Çdo detyrim i shkaktuar nga Agjencia, qoftë me kontratë ose me anë të veprimit të ligjit do të kufizohet vetëm në asetet e Agjencisë, plus pjesa e papaguar e kapitalit nominal të saj. Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi që lidhet me asetet në mirëbesim dhe asetet në mirëbesim nuk mund të preken nga çfarëdo borxhi i Agjencisë.

2. Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet një ndërmarrje dhe asnjë ndërmarrje nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet Agjencisë. Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë veprimi ose mosveprimi të drejtorëve, menaxherëve ose personave të tjerë kontrollues të ndërmarrjeve pavarësisht se a janë emëruar apo jo ata drejtorë, menaxherë a persona të tjerë kontrollues të ndërmarrjes nga Agjencia.

~~3. Asetet tjera të ndërmarrjeve që administrohen nga Agjencia do të mbahen në mirëbesim veçmas nga asetet e Agjencisë. Në përputhje me kriteret të arsyeshme të investimit, fondet të cilat mbahen në mirëbesim nga Agjencia do të investohen në letra me vlerë dhe instrumente të tjera financiare të klasifikuara nga agjenci ndërkombëtare të klasifikimit si letra me vlerë dhe instrumente financiare për investim.~~

3. Asetet tjera të ndërmarrjeve që administrohen nga Agjencia do të mbahen në mirëbesim veçmas nga asetet e Agjencisë.

4. Agjencia në asnjë rast nuk përgjigjet për dëmet që janë si rrjedhim i tërthortë ose si pasojë e masave ndëshkuese.

5. Asnjë person i angazhuar ose i punësuar nga Agjencia dhe asnjë person i cili mban një pozitë menaxheriale ose të drejtorit në Agjenci ose në lidhje me Agjencinë, nuk mban përgjegjësi personale të çfarëdo lloji ndaj cilësdo palë të tretë për dëmet të cilat i janë shkaktuar ose pretendohen të jenë shkaktuar palës së e tretë si rezultat i një veprimi ose lëshimi të Agjencisë ose një veprimi ose lëshimi të personelit, menaxhmentit ose Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, nëse ky veprim ose lëshim është bërë gjatë zbatimit ose ekzekutimit të autoritetit dhe përgjegjësive të Agjencisë të përcaktuara në këtë ligj ose cilitdo element tjetër të ligjit në fuqi në Kosovë ose si pasojë e zbatimit të një interpretimi të arsyeshëm dhe jo qëllimkeq të këtyre autoriteteve dhe përgjegjësive. Të gjitha përgjegjësitë për dëmet e shkaktuara në këtë mënyrë janë përgjegjësi ekskluzive të Agjencisë. Agjencia është e detyruar që t'i sigurojë dhe mbrojë fuqishëm personelin, menaxherët ose drejtorët kundër të cilëve është ngritur një akuzë për këto dëme. Për të shmangur dyshimin, parashihet në mënyrë specifike që ky paragraf nuk e pengon veprimin e asnjë dispozite të asnjë kontrate ndërmjet Agjencisë dhe cilitdo person të angazhuar apo punësuar nga Agjencia, që krijon detyrime dhe të drejta të dëmshpërblimit dhe obligime për palët, vis-a-vis njëra tjetrës.

Neni 19

Politikat financiare, Identifikimi dhe transferimi i Fondeve Tepricë

1. Bordi i nxjerr politikat financiare me qëllim që Agjencia ta kryejë aktivitetin e saj në pajtim me praktikat e shëndosha dhe të arsyeshme të menaxhimit dhe t'i realizojë zotimet e veta financiare pa kërkuar kapitalin e papaguar sipas Nenit 17. Këto politika mund t'i mundësojnë Agjencisë që të kërkojë pagesa administrative, pagesa të transaksioneve dhe shërbimeve nga ndërmarrjet, korporatat dhe nga çdo shfrytëzues tjetër i aktiviteteve të Agjencisë me kusht që këto pagesa të jenë transparente, jodiskriminuese dhe të arsyeshme.

~~2. Përveç asaj që është paraparë në paragrafin 3.3. të këtij neni të gjitha të ardhurat e mbledhura nga Agjencia si rezultat i aktiviteteve të saj sipas nenit 8 dhe 9 të këtij ligji dhe të cilat mbahen në mirëbesim do të investohen nga Agjencia në llogari, instrumente ose mënyra të tjera të investimit të cilat janë ranguar për investim nga agjenci ndërkombëtare të rangimit dhe në përputhje me kriteret e arsyeshme dhe të matura të investimit.~~

3. Për secilin likuidim të nisur nga Agjencia apo paraardhësi i saj sipas paragrafit 2.2. të nenit 6 dhe nenit 9 të këtij ligji, apo sipas dispozitave analoge të legjislacionit zbatueshëm para këtij ligji:

3.1. Agjencia kryen apo kërkon nga autoriteti përkatës i likuidimit që të kryejë rishikim sistematik të të gjitha të ardhurave që dalin nga veprimet e tilla për të përcaktuar pjesën e atyre të ardhurave që përbënë Fonde Tepricë;

3.2. me qëllim ekskluziv të kryerjes së një përcaktimi të tillë, Agjencia apo autoriteti i likuidimit deri në kohën e vërtetimit përfundimtar të vlefshmërisë dhe vlerës së pretendimit në fjalë apo interesit, në pajtim me këtë ligj dhe, nëse kërkesa apo interesi iu është nënshtruar procedurave pranë Dhomës së Posaçme, Ligjit për Dhomën e Posaçme:

3.2.1. supozon që një pretendim që është bërë brenda afatit kohor nga kreditori i supozuar, për sa i përket të ardhurave në fjalë, ka vlerë të barabartë me vlerën maksimale të theksuar në atë pretendim, por vetëm nëse ai pretendim mbështetet me dokumente substanciale dhe të besueshme të cilat janë paraqitur me kohë nga kreditori brenda afateve të përcaktuara nga ky ligj dhe Shtojca e këtij ligji; dhe

3.2.2. supozon që interesi i pronësisë që është pohuar me kohë nga pronari i supozuar për sa i përket të ardhurave në fjalë është i vlefshëm po aq sa edhe interesi i pohuar por vetëm nëse ai interes i pohuar:

3.2.2.1. nuk është lëshuar në bazë të kriterëve të parapara në ligj apo është krijuar përmes kontratës që e ndërlidhë atë materialisht, drejtpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë, me transformimin të cilën Agjencia ka të drejtë ta bëjë nuk i plotëson kriteret e nenit 5 paragrafi 4. të këtij ligji; dhe

3.2.2.2. mbështetet nga dëshmi substanciale dhe të besueshme të cilat janë dorëzuar me kohë nga pronari i supozuar sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj dhe Shtojcën e këtij ligji, por vetëm nëse dëshmitë e tilla demonstronjë në

mënyrë të qartë që ndërmarrja apo personi juridik që i ka lëshuar ato në fakt ka pranuar pagesë të plotë për interesa të pronësisë në pajtim me kushtet që vlejné për çdo kontratë të vlefshme, apo, në mungesë të një kontrate të tillë, në një shumë që i afrohet vlerës reale të interesit.

3.3. Agjencia përcakton dhe deklaron si “Fonde Tepricë” deri në shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të çdo të ardhure që e tejkalon maksimumin e vlerës së përlllogaritur të grumbulluar të pretendimeve përkatëse të kreditorit dhe interesave të pohuara të pronësisë, dhe menjëherë i transferon ato Fonde Tepricë “para publike” dhe trajtohen në pajtim me LMFPP të cilat do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të vendit, me aprovim të Kuvendit të Kosovës;

3.4. në rast se shuma e mbetur në një fond të mirëbesimit nga i cili janë transferuar Fondet Tepricë në Qeveri sipas nën-paragrafit 3.3. më lartë është e pamjaftueshme për përmbushjen e të gjitha kërkesave të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme, AKP e njofton Qeverinë për këtë dhe Qeveria menjëherë do ti ktheje fondet përkatëse në fondin e mirëbesimit nga i cili janë transferuar.

Neni 19/A

Kthimi i fondeve të përkohshme nga Qeveria

1. Në rastet e parapara në nenin 4, paragrafin 3.2.7, të këtij ligji, Qeveria e Kosovës, në emër të Republikës së Kosovës, garanton dhe e ka obligim të pakushtëzuar të Republikës së Kosovës për t’ia kthyer fondet e përkohshme Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike kur të dërgohet kërkesa me shkrim e Agjencisë në Ministrinë e Financave.

2. Kërkesat e Agjencisë drejtuar Ministrisë së Financave për kthimin e fondeve të përkohshme e përbëjnë prioritetin e parë kundër llogarisë së përgjithshme të Thesarit dhe këto fonde të përkohshme nuk do t’i nënshtrohen asnjë ankese apo pretendimi tjetër nga cilado palë. Kthimi i fondeve të përkohshme në Agjenci e ka prioritetin më të lartë në listën e prioriteteve të pagesave të parapara në nenin 38.3 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, nr.04/L-116, nr. 04/L-194, nr. 05/L-063 dhe nr. 05/L-007, (tash e tutje LMFPP).

Neni 19/B

Investimi i fondeve në mirëbesim

1. Përveç asaj që është paraparë në këtë ligj për fondet tepricë, fondet e mbetura dhe fondet e përkohshme, të ardhurat e mbledhura nga Agjencia si rezultat i aktiviteteve të saj sipas ligjit bazik dhe të cilat mbahen në mirëbesim mund të investohen në instrumentet në vijim:

1.1. Llogari rrjedhëse që paguan interes apo depozitë të afatizuar në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe

1.2. Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 20

Raportet, buxheti dhe llogaritë

1. Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe e bën publik raportin vjetor të Agjencisë i cili duhet të përfshijë:

1.1. pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë;

1.2. veçmas nga llogaritë e Agjencisë, pasqyrat financiare të llogarive dhe aseteve të cilat mbahet nga Agjencia në mirëbesim;

1.3. listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1 të këtij ligji;

1.4. listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull;

1.5. listën e ndërmarrjeve të likuiduara sipas nenit 9; dhe

1.6. listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit.

2. Drejtori Menaxhues duhet të përgatisë buxhetin vjetor të të hyrave dhe shpenzimeve të përlllogaritura të Agjencisë si dhe një plan të punës i cili përfshin të gjitha aktivitetet e Agjencisë, për miratim nga Bordi.

Neni 21

Financimi: të hyrat e dedikuara

~~1. Agjencia financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ("LMFPP") të zbatueshme për agjencitë e pavarura.~~

~~2. Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFPP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia menjëherë transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me rregullat në fuqi të LMFPP-së; Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë.~~

~~3. Të gjitha të ardhurat e dedikuara të Agjencisë i nënshtrohen procesit të përvetësimit të krijuar nga LMFPP për agjencitë e pavarura. Çdo e hyrë e tillë e dedikuar që nuk është përvetësuar nga Agjencia për t'u shpenzuar gjatë vitit kalendarik sipas Ligjit përkatës të përvetësimit vjetor,~~

~~mbahet në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë dhe mund të shfrytëzohet vetëm për bërë përvetësime në të ardhmen për Agjencinë.~~

~~4. Agjencia mund të pranojë edhe financim nga palët e treta, me kusht që dhënia dhe marrja e financave të tilla të bëhet në pajtim me LMFPP-në dhe elementet tjera të zbatueshme të së drejtës në Kosovë.~~

Neni 21

Financimi: të hyrat e dedikuara

1. Agjencia Financohet nga të Hyrat e Dedikuara në pajtim me dispozitat e LMFPP të zbatueshme për agjencitë e pavarura.

2. Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFPP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFPP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë.

3. Të gjitha të ardhurat e dedikuara të Agjencisë i nënshtrohen procesit të përvetësimit buxhetor të krijuar nga LMFPP për agjencitë e pavarura. Çdo e hyrë e tillë e dedikuar që nuk është përvetësuar nga Agjencia për tu shpenzuar gjatë vitit kalendarik sipas Ligjit përkatës të përvetësimit vjetor, mbahet në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë dhe mund të shfrytëzohet vetëm për bërë përvetësime në të ardhmen për Agjencinë.

4. Agjencia mund të pranojë edhe financim nga palët e treta, me kusht që dhënia dhe marrja e financave të tilla të bëhet në pajtim me LMFPP-në dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Trajtimi i taksave

~~1. Të ardhurat dhe prona e Agjencisë janë të përjashtuara nga tatimi, me kusht që përjashtimi i tillë të mos vlejë për ndërmarrjet, korporatat, llogaritë dhe asetet e tjera të administruara nga Agjencia si Agjenci mirëbesimi.~~

~~2. Transferi i asetëve dhe shitja e aksioneve në pajtim me nenin 8 dhe 9 nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar.~~

Neni 22 **Trajtimi i tatimeve**

1. Të ardhurat dhe prona e Agjencisë janë të përjashtuara nga tatimi, me kusht që përjashtimi i tillë të mos vlej për ndërmarrjet, korporatat dhe asetet e tjera të administruara nga Agjencia si Agjenci mirëbesimi.
2. Transferi i asetëve dhe shitja e aksioneve në pajtim me nenin 8 dhe nenin 9 të ligjit bazik nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar.

KREU V **LLOGARIDHËNIA**

Neni 23 **Llogaridhënia e Bordit, Menaxhmentit dhe Personelit**

1. Bordi ushtron gjykim të pavarur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësi të tij sipas këtij ligji.
2. Bordi kolektivisht dhe drejtorët individualisht janë përgjegjës në çdo kohë për pajtueshmërinë e aktivitetit të Agjencisë me:
 - 2.1. këtë ligj;
 - 2.2. ligjet e tjera të aplikueshme në Kosovë;
 - 2.3. aktin themelues, aktet nënligjore, politikat operative, financiare dhe të personelit si dhe procedurat e punës së Agjencisë, përveç nëse ato janë modifikuar ose shfuqizuar në pajtim me këtë ligj; dhe
 - 2.4. cilëndo marrëveshje ndërkombëtare që ndërlidhen me Kosovën dhe që i transferojnë funksione ose detyrime Agjencisë.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxhmentit zbatohen nga Bordi. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit zbatohen nga Drejtori Menaxhues. Të gjitha kërkesat për shqyrtimin ligjor të masave të zbatimit të marra, të pranuar ose kundërshtuara nga Bordi do të paraqiten drejtpërdrejt para Dhomës së Veçantë.

Neni 24 **Shpërndarja e Komisioneve të Shqyrtimit; zgjidhja e pretendimeve të pazgjidhura**

1. Të gjitha Komisionet për Shqyrtimin e Ankesave, të themeluara në bazë të legjislacionit që ka qenë në fuqi para këtij ligji shpërndahen dhe nuk krijohet më asnjë komision i shqyrtimit. Agjencia sa më shpejtë që është e mundur, ia kthen parashtruesit çdo ankesë që është dorëzuar nga komisioni i shqyrtimit dhe që nuk është vendosur me vendim përfundimtar të komisionit të

shqyrtimit para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji. Me kthimin e ankesës parashtruesit, Agjencia përfshin në të edhe një njoftim, me datën e dorëzimit të parashtruesi, se ankesa po kthehet në pajtim me kriteret e këtij neni 24, dhe që në bazë të nenit 24.2 të këtij ligji, parashtruesi i ka gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e njoftimit që të ri-parashtrorë ankesën te Dhoma e Posaçme, dhe që mosparashtrimi i saj do të nënkuptojë që parashtruesi do ta humb të drejtën e parashtrimi të ankesës përgjithmonë, apo të pretendimit të çfarëdo çështjeje lidhur me atë ankesë, në çfarëdo tribunali apo procedure gjyqësore apo administrative.

2. Parashtruesi të cilit i kthehet ankesa në bazë të nenit 24.1 i ka gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e njoftimit që të parashtrorë serish ankesë te Dhoma e Posaçme. Nëse parashtruesi nuk e parashtron ankesën në Dhomën e Posaçme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, parashtruesi do ta humb të drejtën e parashtrimi të ankesës përgjithmonë, apo të pretendimit të çfarëdo çështjeje lidhur me atë ankesë, pranë çfarëdo tribunali apo procedure gjyqësore apo administrative.

3. Kthimin e ankesës të parashtruesi Agjencia e bënë përmes postës së rregullt dhe do të përdorë vetëm adresën më të fundit të parashtruesit e cila është dhënë në Agjenci nga parashtruesi. Periudha gjashtëdhjetë (60) ditore e specifikuar në nenin 24.2 fillon të llogaritet në mesnatën e ditës kur ankesa e kthyer iu është dorëzuar parashtruesit.

4. Brenda dyzetepesë (45) ditëve pas kthimit të ankesës sipas këtij neni 24, Agjencia gjithashtu ia kthen parashtruesit në fjalë çdo tarifë të paguar nga parashtruesi lidhur me parashtrimin e ankesës në Agjenci.

Neni 25

Auditimet e jashtme

1. Do të ketë auditime vjetore të Agjencisë, duke përfshirë edhe auditime të jashtme financiare, në përputhje me procedurat standarde të veprimit të përcaktuara nga Ministria e Financave, si dhe auditime plotësuese për të cilat mund të vendosë Kuvendi i Kosovës.

2. Auditimet vjetore përveç Agjencisë do të shtrihen në çdo ndërmarrje dhe llogari besimi që administrohet drejtpërsëdrejti nga Agjencia. Fushëveprimi i çfarëdo auditimi plotësues përcaktohet nga Kuvendi i Kosovës, varësisht nga rasti.

KREU VI

ZBATIMI DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Neni 26

Ndihma nga Qeveria e Kosovës

Kur të kërkohet nga Agjencia, Qeveria, Policia e Kosovës dhe autoritetet tjera publike sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme për zbatimin e kompetencave të Agjencisë dhe urdhrave të lëshuara nga ajo në bazë të këtij ligji.

Neni 27 **Shqiptimi i gjobave**

1. Për zbatimin e kompetencave të saj sipas këtij ligji, Agjencia mund të lëshojë urdhra dhe shqiptojë gjobat e përcaktuara në këtë nen ndaj ndërmarrjeve, punonjësve dhe personave të tjerë me funksione menaxhuese ose mbikëqyrëse mbi ndërmarrjet për:

1.1. mosdhënien e përgjigjes brenda pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i Agjencisë për informatat ose dokumentacionin që është në posedim të të adresuarit, deri në njëmijë (1000) Euro në ditë për çdo ditë të mos përgjigjes - deri në maksimumin prej njëqind mijë (100.000) Euro;

1.2. dhënien me qëllim të informatave të rrejshme një përfaqësuesi të autorizuar të Agjencisë - deri në një qind mijë (100.000) Euro;

1.3. shkatërrimin, falsifikimin, fabrikimin ose fshehjen e të dhënave mbi ndërmarrjen - deri në njëqind mijë (100.000) Euro;

1.4. fshehjen e qëllimshme ose transferimin e paligjshëm të aseteve të ndërmarrjes - deri në pesëdhjetë mijë (50.000) Euro ose një shumë e barabartë me tri herë vlerën e aseteve në fjalë, cilado që është më e lartë; dhe

1.5. mosdorëzimin në Agjenci të çfarëdo aseti të ndërmarrjes pas marrjes së një urdhri me shkrim nga Bordi - deri në pesëdhjetë mijë (50.000) Euro ose shumën e barabartë me tri herë vlerën e aseteve të pa dorëzuara, cilado që është më e lartë.

2. Çdo urdhër për shqiptimin e gjobave konform nenit 27.1 nënshkruhet nga Drejtori Menaxhues ose një Zëvendësdrejtor Menaxhues dhe i dorëzohet ndërmarrjes ose personit në fjalë. Urdhri hyn në fuqi menjëherë pas lëshimit të tij. Ndërmarrja apo personi në fjalë i ka tridhjetë ditë (30) pas dorëzimit të atij urdhri, për ta kundërshtuar atë pranë Dhomës së Posaçme. Dhoma e Posaçme i trajton ankesat e tilla me urgjencë dhe mundet, deri në zgjidhjen e çështjes ta pezullojë urdhrin dhe të shqiptojë masa të përkohshme lehtësuese që Dhoma e Posaçme i konsideron të nevojshme apo të duhura gjatë periudhës së shqyrtimit.

Neni 28 **Përgjegjësia për dëme**

Çdo drejtor i ndërmarrjes dhe çdo person tjetër me funksion menaxhues dhe mbikëqyrës mbi ndërmarrjen është përgjegjës për çfarëdo dëmi të shkaktuar ndërmarrjes si rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve të ligjshme të përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë që vepron sipas autorizimeve të Agjencisë. Agjencia autorizohet të kërkojë në emër të ndërmarrjes në fjalë pagimin e dëmit të tillë në gjykatën kompetente.

Neni 29

Të drejtat e Agjencisë në procedurat ligjore kundër ndërmarrjeve

1. Asnjë procedurë ligjore kundër një ndërmarrje nuk do të mbahet në gjykatë nëse kërkuesi nuk siguron dëshmi me shkrim se Agjencisë i është paraqitur njoftimi me shkrim lidhur me ngritjen e padisë në të cilën duhet të specifikohet emri i kërkuesit, emri i ndërmarrjes dhe të dhënat e tjera identifikuese, baza e ankesës dhe ndihma e kërkuar.
2. Agjencia ka të drejtë ligjore që të kërkojë çfarëdo të drejtash për një ndërmarrje në gjykatën kompetente në emër të asaj ndërmarrje.
3. Kurdo që procedurat ligjore janë në pritje të zgjidhjes së një çështje në emër të një ndërmarrje ose kundër saj, Agjencia në çdo kohë mund ta njoftojë gjykatën kompetente se ajo do të veprojë si përfaqësues ligjor i ndërmarrjes në fjalë, me kusht që ajo të veprojë si përfaqësues ligjor i vetëm një ndërmarrje në procedurën ku palë janë më shumë se një ndërmarrje.

Neni 30

Paditë gjyqësore kundër Agjencisë

1. Dhoma e Veçantë ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë.
2. Dhoma e Veçantë nuk do të pranojë asnjë padi kundër Agjencisë përveç nëse pala paditëse dorëzon dëshminë se e ka njoftuar kryesuesin e Bordit për dorëzimin e një padie të tillë së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para dorëzimit të saj. Me kërkesën e Agjencisë Dhoma e Veçantë mund të pezullojë hapjen e procedurës së padisë që është bërë kundër Agjencisë për një afat i cili nuk mund t'i kalojë gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e pranimit të padisë së tillë për të mundësuar një zgjidhje miqësore.

KREU VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 31

Ligji në fuqi

1. Ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të së drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të. Pa paragjykim ndaj aplikimit të përgjithshëm të fjalisë së mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që Ligji për Procedurën Administrative nuk do të vlejë:
 - 1.1. për çfarëdo veprimi të ndërmarrë nga Agjencia sipas autorizimeve të këtij ligji lidhur me privatizimin, likuidimin, shitjen, transferimin, restrukturimin, riorganizimin apo mënyrat tjera të zgjidhjes së një ndërmarrje, korporate apo aseti; dhe
 - 1.2. për trajtimin dhe përcaktimin nga Agjencia të autoritetit të likuidimit të çfarëdo pretendimi apo interesi të bërë apo të pohuar nga cilido person si kreditor apo pronar i supozuar.

2. Me këtë ligj shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-067, “për Agjencinë Kosovare të Privatizimit”.

3. Agjencia merr përsipër të gjitha asetet dhe detyrimet të cilat ajo ose paraardhësja e saj i ka mbajtur, fituar apo shkaktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12. Bordi dhe menaxhmenti i Agjencisë i përmbushin të gjitha përgjegjësitë e cilitdo Bordi ose menaxhmenti paraardhës të emëruar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

4. Pa paragjykim ndaj fushëveprimit të përgjithshëm të paragrafit të mëparshëm apo paragrafit 2. të nenit 3 të këtij ligji, parashihet në mënyrë specifike që Agjencia është trashëgimtarja ligjore dhe ekskluzive e cilësdo apo të gjitha të drejtave dhe obligimeve të AKM-së që janë specifikuar apo kanë dalë në lidhje me ndonjë kontratë që është ekzekutuar më parë nga AKM-ja dhe një apo më shumë palë të treta që si objekt kryesor të tyre kanë pasur menaxhimin, operimin, shitjen, transferimin, likuidimin apo ndonjë mënyrë tjetër të disponimit me ndërmarrjen, korporatën, asetin apo çfarëdo interesi në cilëndo nga këto. Çdo referim i kontratave të tilla në AKM do të interpretohet në mënyrë përfundimtare se nënkupton Agjencinë. Çdo referim i kontratave të tilla në Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm do të interpretohet në mënyrë përfundimtare se nënkupton Bordin e Agjencisë. Nëse kontrata përmban një apo më tepër dispozita që specifikojnë që kontrata bazohet në ndonjë ligj të ndonjë shteti të huaj:

4.1. as ajo dispozitë e as ai ligj i shtetit të huaj nuk përdoret, interpretohet apo zbatohet në mënyrë të tillë që të shmangë apo pakësojë kriteret e paraqitura më lart në këtë paragraf; dhe

4.2. ky paragraf nuk interpretohet si paragraf që e bën të vlefshëm apo të pavlefshëm, në tërësi apo pjesërisht, në çfarëdo mënyre, zgjedhjen e ligjit të specifikuar në atë dispozitë; vlefshmëria apo pavlefshmëria përcaktohet në pajtim me rregullat e aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare private.

~~5. Drejtorët e Bordit të emëruar nga PCN sipas nenit 12, paragrafi 3. do të vazhdojnë të qëndrojnë në pozitat e tyre edhe pas përfundimit të mandatit të PCN dhe do të kompensohen nga të ardhurat e dedikuara të AKP-së përveç nëse vendoset ndryshe nga PCN para përfundimit të mandatit të tij.~~

~~[paragrafi 6 ka vlejtur deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve ndërkombëtar të Bordit më 31 Gusht 2014.]~~

~~6. Nëse një anëtar ndërkombëtar i bordit i emëruar në pajtim me nenin 31 (5) jep dorëheqje nga Bordi dhe nëse kjo dorëheqje ose largim nga posti ndodh deri më 31 gusht 2014 atëherë ai/ajo do të zëvendësohet me një ndërkombëtar tjetër.~~

Neni 32 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-034
31 gusht 2011

Shpallur me dekretin Nr. DL-025-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

PJESA I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi dhe zbatueshmëria e kësaj Shtojce

Kjo Shtojcë përcakton bazat dhe procedurat për likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve mbi të cilat Agjencia ka autoritet, në pajtim me Ligjin për AKP-në dhe të drejtat dhe obligimet e të gjithë pjesëmarrësve dhe palëve të prekura.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllime të interpretimit dhe aplikimit të kësaj Shtojce, termat e përkufizuar në nenin 3 të Ligjit për AKP-në dhe termat shtesë, kurdoherë që të përdoren në këtë Shtojcë, kanë domethënie e përcaktuar përveç nëse konteksti në të cilin paraqitet termi qartësisht ka kuptim tjetër:

1.1. **Dispozitat e shpalljes**, do të thotë dispozitat që kanë të bëjnë me shpalljet sipas nenit 49 të kësaj Shtojce;

1.2. **Ditë pune**, do të thotë një ditë e javës në të cilën institucionet e Kosovës janë të hapura për punë në Prishtinë, përveç të shtunave, të dielave dhe festave publike në Kosovë;

1.3. **Gjykata**, do të thotë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Kosovës;

1.4. **Afati për dorëzimin e kërkesave**, do të thotë data e përcaktuar në nenin 7;

1.5. **Likuidimi**, do të thotë procesi ligjor që përfshin shitjen e asetëve të një Ndërmarrje, shpërndarjen e të hyrave në pajtim me nenin 40 të kësaj Shtojce dhe ndërprerjen e ekzistimit të Ndërmarrjes në pajtim me dispozitat e kësaj Shtojce;

1.6. **Vendimi për likuidim**, do të thotë vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për iniciuar një likuidim;

1.7. **Data e vendimit për likuidim**, do të thotë data në të cilën Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka miratuar Vendimin për likuidim;

1.8. **Autoriteti i likuidimit**, do të thotë Agjencia apo personi(at) i autorizuar nga Agjencia dhe i caktuar nga Bordi sipas këtij Ligji që të veprojë si Autoritet i Likuidimit i një Ndërmarrje në procedurë të likuidimit;

1.9. **Menaxheri apo Menaxhmenti**, do të thotë zyrtari apo zyrtarët kryesorë ekzekutivë të një Ndërmarrje;

1.10. **Kontrata e qirasë**, do të thotë të drejtat pronësore sipas përshkrimit në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13 të datës 9 maj 2003 për Transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore;

~~1.11. **Ligji për AKP-në**, do të thotë Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i vitit 2011, të cilit i është bashkëngjitur kjo Shtojcë;~~

1.11. **Ligji për AKP-në**, do të thotë Ligji nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080, të cilit i është bashkëngjitur kjo shtojcë;

1.12. **Person**, do të thotë person fizik, person juridik, ndërmarrje apo autoritet publik;

1.13. **Ofrues i shërbimeve profesionale**, do të thotë një individ apo subjekt i angazhuar në ofrimin e shërbimeve profesionale për Agjencinë;

1.14. **Dëshmia e kërkesës**, do të thotë dokumenti i dorëzuar nga një kreditor i supozuar i Ndërmarrjes në formën e përshkruar nga Agjencia dhe që përcakton informata dhe hollësi lidhur me Kërkesën në fjalë të përshkruar në nenin 23 të kësaj Shtojce;

1.15. **Dëshmia e interesit**, do të thotë dokumenti i dorëzuar nga një pronar i pretenduar i Ndërmarrjes apo një aset të saj në formën e përshkruar nga Agjencia dhe që përcakton informata dhe hollësi lidhur me interesin e pretenduar të pronësisë të përshkruar në nenin 23 të kësaj Shtojce;

1.16. **Kreditor i regjistruar**, do të thotë personi/kreditori që ka i cili ka parashtruar Dëshmi të Kërkesës e cila është pranuar, tërësisht apo pjesërisht, nga ana e Autoritetit të Likuidimit, me kusht që ai Person humbet statusin e tij si “Kreditor i regjistruar” nëse Dëshmia e Kërkesës refuzohet në tërësi. Personi të cilit i është refuzuar Dëshmia e Kërkesës në tërësi nga ana e Autoritetit të Likuidimit bëhet “Kreditor i regjistruar” nëse dhe pasi që Gjykata të urdhërojë Autoritetin e Likuidimit ta pranojë Dëshminë e Kërkesës tërësisht apo pjesërisht;

1.17. **Bartësi i regjistruar i interesit**, do të thotë Personi që ka parashtruar Dëshmi të Interesit e cila është pranuar, tërësisht apo pjesërisht, nga ana e Autoritetit të Likuidimit; me kusht që ai Person humb statusin e tij si “Bartës i regjistruar i interesit” nëse dhe pasi që Gjykata më pas urdhëron që ajo Dëshmi e Interesit të refuzohet në tërësi. Një Person, Dëshmia e Interesit e të cilit është refuzuar tërësisht nga ana e Autoritetit të Likuidimit bëhet “Bartës i regjistruar i interesit” nëse dhe pasi Gjykata të ketë urdhëruar Autoritetin e Likuidimit të pranojë Dëshminë e Interesit të tillë tërësisht apo pjesërisht;

1.18. **Kreditor i siguruar**, do të thotë Kreditori me kërkesa të siguruara apo të drejta për realizimin e kërkesës së tij përmes asetëve apo të drejtave të specifikuara që janë të regjistruara në regjistra apo libra të tjerë publikë;

1.19. **Kërkesë e siguruar**, do të thotë çdo Kërkesë që është siguruar në mënyrë të duhur dhe të ligjshme me anë të një garancie ndaj një Aseti të Ndërmarrjes, qoftë në formë të pengut, garancisë, hipotekës apo interesave të tjerë të ligjshëm të siguruar.

Neni 3 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Shtojce rregullojnë procesin e likuidimit të Ndërmarrjes, pavarësisht nëse ai është iniciuar sipas Ligjit të AKP-së apo legjislacionit tjetër përkatës pararendës.

PJESA II PROCEDURAT FILLESTARE

Neni 4 Bazat për iniciimin e rasteve të likuidimit dhe vendimeve të likuidimit.

Rastet e likuidimit sipas Ligjit për AKP-në iniciohen nga Bordi i Drejtorëve i AKP-së me vendim të nxjerrë në pajtim me autoritetin e AKP-së sipas nenit 9.1 të Ligjit të AKP-së dhe vendimi i tillë është në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 15.2.13 të Ligjit për AKP-në.

Neni 5 Fillimi i likuidimit

Menaxhmenti i AKP-së përgatit propozimin për Bordin për fillimin e likuidimit të një Ndërmarrje. Forma dhe përmbajtja e propozimit përkufizohet në Politikat Operacionale të nxjerra nga Bordi në pajtim me nenin 10 të Ligjit për AKP-në.

Neni 6 Pasojat e vendimit të bordit për likuidim

Pas Vendimit për likuidim, Bordi emëron Autoritetin e Likuidimit, në pajtim me procedurën e përshkruar në nenin 12 të kësaj Shtojce.

Neni 7 Njoftimi për likuidim

1. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së Vendimit për likuidim, Agjencia publikon, apo kërkon nga Autoriteti i Likuidimit të publikojë njoftimin me informatat e cekura në paragrafin 2 të këtij neni (Njoftimi për likuidim). Publikimi i Njoftimit për likuidim bëhet në pajtim me Dispozitat për Shpallje të kësaj Shtojce.

2. Njoftimi për likuidim titullohet, me shkronja të mëdha dhe të theksuara të shtypit, “njoftim për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes”, dhe përfshin informatat në vijim:

2.1. datën dhe përshkrimin e përgjithshëm të Vendimit për likuidim;

2.2. referencë në këtë ligj dhe këtë shtojcë si dhe një përshkrim të përgjithshëm të të drejtave të Personave që kanë Dëshmi të Interesit;

2.3. një deklaratë që Autoriteti i Likuidimit administron likuidimin sipas këtij ligji dhe kësaj shtojce;

2.4. hollësi lidhur me atë se si të sigurohen formularët për Dëshmi të Kërkesës dhe Dëshmi të Interesit dhe metoda për parashtrimin e Dëshmime të Kërkesës apo Dëshmime të Interesit, bashkë me një indikacion të qartë e të theksuar të afatit për parashtrimin e Dëshmisë të Kërkesës dhe Interesit (“Afati për parashtrimin e kërkesave”);

2.5. një deklaratë që vetëm Kreditorët e regjistruar dhe Bartësit e regjistruar të interesit të përcaktuar të tillë në pajtim me këtë ligj dhe këtë shtojcë, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpërndarjen e të hyrave që rezultojnë nga likuidimi i Ndërmarrjes, si dhe vetëm për aq sa përcaktohet me këtë ligji dhe këtë shtojcë.

2.6. njoftimin që:

2.6.1. saktëson adresën dhe hollësitë tjera të kontaktit që përdoren për parashtrimin e Dëshmime të Kërkesës dhe Dëshmime të Interesit dhe komunikimeve tjera me Autoritetin e likuidimit;

2.6.2. përfshin një deklaratë të qartë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes duhet të parashtrorjnë Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularët përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda Afatit për parashtrimin e kërkesave, që do të caktohet në 16:00 në një ditë pune dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje;

~~2.6.3. përfshin një deklaratë të qartë me shkronja të theksuara se të gjithë Personat që pretendojnë të kenë Kërkesa apo interesa në apo ndaj ndërmarrjes duhet të veprojnë në pajtueshmëri me kërkesat e saktësuara në njoftim, pavarësisht nëse më herët e kanë informuar Gjykatën, Agjencinë apo pararendësin e Agjencisë (Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit) në lidhje me të;~~

2.6.3. përfshin një deklaratë të qartë me shkronja të theksuara se të gjithë Personat që pretendojnë të kenë kërkesa apo interesa në apo ndaj ndërmarrjes duhet të veprojnë në pajtueshmëri me kërkesat e saktësuara në njoftim dhe të përsërisin dëshminë e kërkesës apo të interesit; pavarësisht nëse më herët e kanë parashtruar një kërkesë të tillë apo informuar Gjykatën, Agjencinë apo pararendësin e Agjencisë (Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit) në lidhje me të;

2.6.4. përfshin një deklaratë të qartë me shkronja të theksuara se të gjitha Kërkesat dhe Interesat që nuk janë parashtruar si duhet deri në Afatin për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të jenë përgjithmonë të parashkruara dhe të pa ekzekutueshme;

dhe

2.6.5. përfshin një indikacion të qartë se ku dhe si një person mund të sigurojë formularë standard për parashtrimin e Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit.

3. Autoriteti i Likuidimit mund të përfshijë informata tjera në njoftimin për likuidim nëse e konsideron të nevojshme.

4. Autoriteti i likuidimit brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së publikimit të parë Njoftimit për Likuidim në publikimin e specifikuar në Dispozitat për Shpallje, i dërgon me postë një kopje të Njoftimit për likuidim çdo personi që më herët ka informuar me shkrim Agjencinë apo Gjykatën lidhur me Kërkesën apo interesin e pretenduar ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes. Agjencia gjithashtu e përfshin një letër që informon personat e tillë se ata duhet të parashtrorjnë Dëshmi të Kërkesës apo Dëshmi të Interesit në pajtim me Njoftimin për likuidim. Dispozitat e këtij paragrafi 4. nuk aplikohen nëse nuk mund të konstatohet lehtë adresa e personit në fjalë apo përfaqësuesit ligjor nga regjistrat e Agjencisë apo të Gjykatës që në mënyrë substanciale ndërliidhen me ndërmarrjen në fjalë.

~~5. Brenda pesëmbëdhjetëmijë (15) ditësh pas publikimit fillestar të Njoftimit për likuidim, Autoriteti i Likuidimit publikon përsëri njoftimin në pajtim me Dispozitat për shpallje. Për të shmangur dyshime, ky publikim i Njoftimit për likuidim ka ndikim në datën dhe kohën e Afatit për parashtrimin e kërkesave, i cili mbetet ai që është saktësuar në njoftimin fillestar.~~

5. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas publikimit fillestar të Njoftimit për likuidim, Autoriteti i Likuidimit publikon përsëri njoftimin në pajtim me Dispozitat për shpallje. Për të shmangur dyshime, ky publikim i Njoftimit për likuidim nuk ka ndikim në datën dhe kohën e Afatit për parashtrimin e kërkesave, i cili mbetet ai që është saktësuar në njoftimin fillestar.

Neni 8

Anulimi i të gjitha kontratave të punës

Në mesnatën e Datës së Vendimit për Likuidim prishen të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse të tilla ekzistojnë.

Neni 9

Ndërprerja e të drejtave të menaxhmentit të ndërmarrjes apo autoriteteve tjera menaxhuese

Në mesnatën e Datës së Vendimit për Likuidim, të drejtat e menaxhmentit të ndërmarrjes apo autoritetit tjetër menaxhues, përfaqësuesve apo të autorizuarve, si dhe të organit menaxhues dhe organeve mbikëqyrëse të ndërmarrjes do të ndërpriten dhe këto drejta barten te Autoriteti i Likuidimit.

Neni 10 **Pezullimi i veprimeve**

1. Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo aseteve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij neni 10 dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim.

2. Veprimet, procedurat apo aktet e tilla të pezulluara mund të vazhdojnë apo të jenë në fuqi vetëm me leje të Autoritetit të likuidimit apo të Gjykatës. Këto veprime, procedura dhe akte përfshijnë mes tjerash, çdo veprim, procedurë apo akt:

2.1. që ka të bëjë me grumbullimin, kthimin apo zbatimin e Kërkesave për borxhe, taksa, gjoba apo obligime të çfarëdo lloji;

2.2. që ka të bëjë me krijimin, pranimin, modifikimin, rritjen, përmbyshjen, regjistrimin apo zbatimin e çdo Kërkesë apo Interesi kundrejt Ndërmarrjes apo çdo aset të ndërmarrjes;

2.3. çdo akt për realizimin, marrjen nën kontroll apo shitjen e aseteve të lëna peng, të hipotekuara apo që me çdo formë tjetër barre, apo ushtrimi i kontrollit mbi çdo aset të ndërmarrjes; dhe

2.4. procedurat apo veprimet rregullative që kanë të bëjnë me parandalimin apo korrigjimin e shkeljeve të dispozitave rregullative, rregullave apo vendimeve përderisa ato kanë të bëjnë me pretendime monetare ndaj ndërmarrjes.

3. Pezullimi i veprimeve, procedurave dhe akteve nuk aplikohet në:

3.1. veprimet gjyqësore që në emër të ndërmarrjes drejtohen kundër palëve të treta;

3.2. procedurat penale ndaj ndërmarrjes apo një apo më shumë anëtarëve të Menaxhmentit të saj;

3.3. transferimet apo disponimi me asetet e ndërmarrjes gjatë rrjedhës së rregullt të punës së ndërmarrjes, përfshirë transaksionet e përcaktuar në këtë Ligj dhe në veçanti në nenin 10;

3.4. procedurat apo veprimet rregullative që kanë të bëjnë me parandalimin apo korrigjimin e shkeljeve të dispozitave rregullative, rregullave apo vendimeve, nëse ato nuk përfshijnë pretendime monetare ndaj ndërmarrjes; dhe

3.5. inspektimet dhe kërkesat për inspektim të parashtruara nga bartësit e hipotekave të regjistruara, garancive të vërteta apo pengjeve të ngjashme që kanë të bëjnë me asetet e ndërmarrjes.

Neni 11

Obligimet shërbyese të Ofruesve të shërbimeve publike

1. Ofruesi i shërbimeve publike nuk mund të ndryshojë, refuzojë apo ndërpresë shërbimet e tij për një ndërmarrje për shkak që Bordi ka miratuar Vendim për Likuidim për ndërmarrjen në fjalë apo që prek atë.
2. Nëse Vendimi për Likuidim është miratuar, Ofruesi i shërbimeve publike nuk mund të ndryshojë, refuzojë apo ndërpresë shërbimet e tij për ndërmarrjen për shkak që kjo ndërmarrje nuk ka paguar shërbimet e ofruara para datës së Vendimit për Likuidim. ndërmarrja do të obligohet t'i paguajë shërbimet publike të ofruara pas datës së Vendimit për likuidim.

PJESA III

AUTORITETI I LIKUIDIMIT

Neni 12

Themelimi i Autoritetit të Likuidimit; Caktimi i Anëtarëve

1. Autoriteti i Likuidimit konsiderohet si i themeluar prej datës së Vendimit për Likuidim.
2. Bordi cakton personin(at) që do të shërbejë në Autoritetin e Likuidimit pas Vendimit për Likuidim.

Neni 13

Përbërja e Autoritetit të Likuidimit

1. Bordi i AKP-së do të emërojë një ose me shumë Ofrues të Shërbimeve Profesionale që të shërbejnë si Autoriteti Likuidues për cdo likuidim përveç kur objekti i likuidimit është një ndërmarrje që nuk ka asnjë pasuri ose kundër të cilës nuk është paraqitur asnjë kërkesë në afat, në këto raste anëtarët e Autoritetit të Likuidimit mund të emërohen nga radhët e personelit të AKP.

~~2. Nëse një Autoritet i Likuidimit nuk përbëhet nga Ofrues të Shërbimeve Profesionale, Bordi i AKP do të sigurojë që të paktën një anëtar i këtij Autoriteti të Likuidimit të jetë përfaqësues i një komuniteti pakicë.~~

~~3.~~ 2. Bordi i AKP-së cakton një anëtar të Autoritetit të Likuidimit të shërbejë si kryesues; ky emërim, po ashtu, bëhet në pajtim me Politikën Operacionale.

~~3.~~ Përgjashtëmishit nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, Bordi mund të emërojë anëtarët e Autoritetit të Likuidimit nga radhët e personelit të Agjencisë, në rastet kur administrimi i ndërmarrjes në likuidim rrezikohet në mungesë të angazhimit të Ofruesve të Shërbimeve Profesionale.

Neni 14

Emërimi i Ofruesve të Shërbimeve Profesionale

Bordi mund të emërojë Ofruesit e Shërbimeve Profesionale nëse konsideron se shërbimet e tyre janë të nevojshme për Autoritetin e Likuidimit. Këto emërimë bëhen në pajtim me Politikat Operacionale.

Neni 15

Kualifikimet e ofruesit të shërbimeve profesionale që shërben apo që ofron shërbime për Autoritetin e Likuidimit

1. Çdo Ofrues i Shërbimeve Profesionale

1.1. duhet të jetë kontabilist i licencuar, auditor, jurist, profesionist që ka njohuri të shkëlqyeshme të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut ose person tjetër që posedon trajnimin ose përvojën e përshtatshme për nevojat e rastit; dhe

1.2. duhet të ketë së paku diplomë të avancuar universitare dhe të ketë së paku tri (3) vite përvojë profesionale.

2. Një person nuk mund të caktohet anëtar i Autoritetit të Likuidimit apo të angazhohet si ofrues i shërbimeve profesionale nëse:

2.1. ai person është dënuar për krim të qëllimtë, përveç kundërvajtjeve të trafikut, apo, në formë ndëshkimi për sjellje të pahijshme, është privuar nga e drejta për të zënë pozitë të lartë në organ menaxhues apo qeverisës;

2.2. ai person është i dyshuar, i akuzuar apo i pandehur në procedura penale në kohën e emërimit;

2.3. ndaj tij ka kërkesëpadi apo nëse ka obligim ndaj ndërmarrjes në vlerë prej mbi pesëqind (500) Euro;

2.4. njihet si person që i mungon kapaciteti apo ka kapacitet të kufizuar;

2.5. gjatë vitit të kaluar ka qenë anëtarë i organit qeverisës apo menaxhmentit të lartë, kontabilist, auditor i pavarur, apo avokat për ndërmarrjen apo nëse është anëtar i ngushtë i familjes i ndonjë pjesëtari të organit qeverisës apo menaxhmentit të lartë, kontabilisti, auditori të pavarur, apo avokati të ndërmarrjes;

2.6. është person fizik apo juridik në procedurë të paaftësisë së pagimit (insolencës);

2.7. është larguar nga pozita e Autoritetit të Likuidimit apo e Komitetit të Likuidimit në pesë (5) vitet e fundit me iniciativë të Agjencisë apo Gjykatës për keqsjellje të rëndë;

2.8. është përcaktuar nga gjykata apo një organ apo tribunal tjetër i pavarur se ka shprehur sjellje të pahijshme apo neglizhencë;

2.9. ai person zotëron attribute tjera që përbëjnë konflikt të interesit apo që pengojnë aftësinë e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale në kryerjen e detyrave të tij në pajtim me këtë ligj.

Neni 16

Kompensimi i Ofruesve të Shërbimeve Profesionale

~~Tarifat dhe shpenzimet e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale paguhen nga mjetet që i janë ndarë Agjencisë nga buxheti i Republikës së Kosovës ose nga mjetet e siguruara nga një donator. Agjencia ose donatori që paguan këto tarifa dhe shpenzime ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e tyre në bazë të prioritetit të përcaktuar në nenin 40 të kësaj Shtojce;~~

Neni 16

Pagesa e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale dhe shpenzimeve tjera të likuidimit

1. Tarifat dhe shpenzimet e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale në procesin e likuidimit dhe kostot e procesit të likuidimit të parapara në paragrafët 1.1 deri 1.3 të nenit 40 të shtojcës së ligjit bazik do të paguhen nga llogaritë e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse.

2. Në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme nga llogaritë e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse për të mbuluar kostot e parapara në paragrafin 1.1 dhe paragrafin 1.3 të nenit 40 të shtojcës së ligjit bazik, atëherë këto kosto do të mbuloohen nga tarifa administrative e Agjencisë.

Neni 17

Detyrimet, kontabiliteti dhe raportimi

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tij, Autoriteti i Likuidimit dhe anëtarët e tij dhe Ofruesit e Shërbimeve Profesionale sigurojnë që:

1.1. kryerja e detyrave bëhet në mënyrë të paanshme dhe profesionale; dhe

1.2. t'i kushtojnë kujdes dhe vëmendje fiduciare (të mirëbesimit) të arsyeshme dhe profesionale kryerjes së këtyre përgjegjësive.

2. Nëse një Person që nuk është përfaqësues i Agjencisë caktohet në Autoritetin e Likuidimit, ai Person i dorëzon Agjencisë fletëobligacion në shumën e mjaftueshme për të shërbyer si garanci për kryerjen adekuate të detyrave të Autoritetit të Likuidimit të atij Personi në pajtim me këtë Ligj. Shuma e obligacionit përcaktohet në pajtueshmëri me Politikën Operacionale të Agjencisë.

3. Anëtarët e Autoritetit të Likuidimit dhe Ofruesit e Shërbimeve Profesionale nuk mund të jenë përgjegjës për:

3.1. dëmet e shkaktuara nga ndërmarrja apo ndonjë Person tjetër si rrjedhojë e vendimeve apo veprimeve të marra apo që nuk janë ndërmarrë në kuadër të fushëveprimit të detyrave të tyre, përveç nëse ato dëme drejtpërsëdrejti janë shkaktuar nga dështimi i qëllimit apo neglizhenca e theksuar e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit apo Ofruesi i Shërbimeve Profesionale në kryerjen e përgjegjësive të tyre në pajtim me dispozitat e cekura në

paragrafin 1. më lart; apo

3.2. dëmet që dalin nga dështimi i ndërmarrjes për t'i kryer obligimet e përcaktuara me ligje apo akte nënligjore në lidhje me çështje të punës, shëndetësore, të sigurisë apo mjedisore.

4. Autoriteti i Likuidimit, në pajtim me këtë ligj, mund të marrë në kontroll dhe/apo shesë asetet nëse Autoriteti i Likuidimit – përmes ushtrimit të kujdesit dhe vëmendjes së arsyeshme – konstaton se ka baza të arsyeshme ligjore të besojë që aset i është aset i ndërmarrjes. Nëse një aset i tillë shitet apo në mënyra tjera zgjidhet, dhe më vonë Gjykata përcakton që një person tjetër, ndryshe nga ndërmarrja, ka pasur – në kohën e shitjes apo zgjidhjes – të drejtë aktualisht të vlefshme dhe të zbatueshme ndaj atij asemi sipas ligjeve të Kosovës, Autoriteti i Likuidimit nuk është përgjegjës për humbjet apo dëmet ndaj cilitdo person që kanë rezultuar nga ajo shitje; megjithatë, personat që pretendojnë që kanë interes të ligjshëm në atë aset i gëzojnë të drejtat e saktësuara në paragrafin 5 më poshtë.

5. Çdo person që pretendon të ketë interes të ligjshëm në cilëndo pronë që është shitur apo në mënyra tjera zgjidhur nga ana e Autoritetit të Likuidimit mund të aplikojë në Gjykatë për kompensim adekuat monetar brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditëve pas shitjes apo zgjidhjes së tillë. Nëse Gjykata nxjerr konkludim në favor të këtij personi, Gjykata urdhëron pagesën e kompensimit adekuat monetar për këtë person, të barasvlershme me vlerën e arsyeshme të interesit të tij në pronën që është prekur negativisht nga ajo shitje apo zgjidhje. Kompensimi i tillë duhet të paguhet nga të hyrat e pranuar prej shitjes apo zgjidhjes në mënyra tjera të asaj prone. Nëse Gjykata konstaton se këto të hyra nuk janë të mjaftueshme për t'i ofruar personit në fjalë kompensimin adekuat monetar, ndryshimi do të pranohet nga personi në cilësi të kreditorit të pasiguruar në likuidim.

6. Autoriteti i Likuidimit mban shënime të rregullta lidhur me kryerjen e funksioneve të tij. Autoriteti i Likuidimit fut në këto shënime përshkrimin e hollësishëm të çdo veprimi të tij në lidhje me ushtrimin e përgjegjësive dhe autorizimeve të tij sipas nenit 18 dhe administrimit të ndërmarrjes.

7. Autoriteti i Likuidimit publikon raporte të përgjithshme vjetore lidhur me mbarëvajtjen e likuidimit që përmbajnë së paku informatat në vijim:

7.1. listën e pronave të shitura, transferuara apo të zgjidhura në mënyra tjera;

7.2. listën e pranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme;

7.3. indikacion, nëse ka, të përfundimit të mundshëm të likuidimit;

7.4. shpjegim të të gjitha çështjeve që zvarritin përmbylljen e rastit të likuidimit.

8. Pa paragjykim të dispozitave të mëparshme, Autoriteti i Likuidimit ofron informata dhe risi shtesë në lidhje me aktivitetet, kohë pas kohe dhe sipas kërkesave të arsyeshme të komitetit të kreditorëve, nëse ai themelohet nga Agjencia.

9. Raportet e përgatitura nga Autoriteti i Likuidimit vihen në dispozicion për inspektim, nëse kërkohen nga cilido kreditor i konfirmuar, si dhe publikohen në faqen e internetit të Agjencisë përkrah komunikatës për shtyp për të joshur vëmendjen e opinionit publik lidhur me raportin.

Neni 18

Përgjegjësitë dhe autorizimet e përgjithshme të Autoritetit të Likuidimit

1. Varësisht nga dispozitat tjera specifike të aplikueshme të këtij ligji, Autoriteti i Likuidimit ka përgjegjësi dhe autoritet që të ndërmerr veprime adekuate dhe sipas nevojës, lidhur me mbarëvajtjen e likuidimit, përfshirë, mes tjerash si në vijim:

1.1. krijimin dhe kompletimin e një regjistri të të gjitha aseteve dhe detyrimeve të ndërmarrjes dhe degëve të saj;

1.2. mbajtjen dhe ruajtjen e llogarive dhe korrespondencës afariste të ndërmarrjes;

1.3. marrjen në posedim, grumbullimin, rikthimin dhe të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e aseteve të ndërmarrjes dhe, për këtë qëllim, hyrjen apo inicimin e procedurave të tilla sipas volisë së Autoritetit të Likuidimit;

~~1.4. me miratimin paraprak të Bordit, shitjen apo zgjidhjen në mënyra tjera e asetit(ve) të ndërmarrjes përmes tenderit publik konkurrues (i cili do të drejtohet nga Agjencia), apo në raste të jashtëzakonshme pas negociatave direkte, përfshirë shitjen e këtyre aseteve të spastruara nga të gjithë pengjet dhe interesat;~~

1.4. me miratimin paraprak të Bordit, shitjen apo zgjidhjen në mënyra tjera e asetit(ve) të ndërmarrjes përmes tenderit publik konkurrues (i cili do të drejtohet nga Agjencia), apo pas negociatave direkte bazuar në aktet nënligjore të miratuara nga Bordi i Drejtorëve, përfshirë shitjen e këtyre aseteve të spastruara nga të gjithë pengjet dhe interesat;

1.5. ekzekutimin në emër të ndërmarrjes të kontratave, titujve, fletëpranimeve apo dokumenteve tjera;

1.6. hartimin, pranimin, nxjerrjen dhe miratimin e kambialeve apo shkresave premtuese në emër të ndërmarrjes;

1.7. operimin, hapjen, mbylljen dhe konsolidimin e llogarive bankare të ndërmarrjes dhe kryerjen e pagesave të rastit apo të nevojshme për kryerjen e funksioneve të Autoritetit të Likuidimit;

1.8. mbylljen e të gjitha llogarive ekzistuese bankare të ndërmarrjes, për të hapur një llogari speciale të likuidimit në një Bankë të aprovuar nga Agjencia me vendndodhje dhe e regjistruar në Republikën e Kosovës për depozitimin e të gjitha fondeve të pranuar në emër të ndërmarrjes dhe të fondeve të ndërmarrjes nga llogaritë ekzistuese në këtë llogari para mbylljes së tyre;

1.9. konvertimin e letrave me vlerë të ndërmarrjes në para të gatshme në pajtim me dispozitat e Ligjit;

1.10. angazhimin apo marrjen e shërbimeve të Ofruesve të Shërbimeve Profesionale sipas nevojës për Autoritetin e Likuidimit për t'i ndihmuar në kryerjen e detyrave dhe funksioneve të Autoritetit të Likuidimit sipas këtij ligji;

1.11. arritjen, mbrojtjen dhe hyrjen në aranzhime apo kompromise për të shmangur apo përfunduar veprime apo procedura tjera ligjore në emër të ndërmarrjes, nëse është e domosdoshme apo e këshillueshme për të mbrojtur apo avancuar vlerën e ndërmarrjes apo asetëve të saj;

1.12. emërimin e agjentit për kryerjen e punëve të ndërmarrjes, të cilat Autoriteti i Likuidimit nuk është në gjendje t'i bëjë vetë apo nëse ato mund të bëhen në mënyrë më të përshtatshme nga agjenti;

1.13. marrjen, ndërprerjen apo mbajtjen e sigurimeve në lidhje me punën dhe asetet e ndërmarrjes;

1.14. konstatimin dhe ndjekjen e të drejtave ligjore që ndërmarrja mund t'i ketë ndaj një Personi i cili është në borxh të ndërmarrjes, dhe ushtrimi i të drejtave të ndërmarrjes si kreditor i këtij Personi;

1.15. themelimin apo ndryshimin e zyrës së regjistruar apo agjentit të regjistruar të ndërmarrjes;

1.16. shqyrtimin e Dëshmimeve të Kërkesës dhe Dëshmimeve të Interesit të parashtruar sipas këtij ligji dhe, nëse ka bazë të arsyeshme për të kundërshtuar një Kërkesë të tillë në tërësi apo pjesërisht, refuzimin dhe/apo parashtrimin e kundërshtimeve për të, në tërësi apo pjesërisht;

1.17. shitjen e mallrave të prishshme që imponojnë kosto të konsiderueshme të mirëmbajtjes, ashtu siç konstaton së është më së përshtatshmi Autoriteti i Likuidimit;

1.18. ndërmarrjen e veprimeve tjera të rastit për ushtrimin e aktiviteteve të mëparshme apo që mund të jenë urdhëruar nga Gjykata.

2. Autoriteti i Likuidimit mund t'i dorëzojë bartësve të letrave me vlerë çdo aset që konsiderohet të jetë përkatëse për interesin kapital, apo – nëse ka baza të arsyeshme për të besuar se vlera e atij aseti materialisht tejkalon shumën e borxhit në fjalë – të shesë asetin e tillë përmes tenderit publik konkurrues (që do të kryhet nga Agjencia) dhe të hyrat nga kjo shitje të përdoren për zgjidhjen e kërkesave të kreditorëve të tjerë.

3. Autoriteti i Likuidimit, me leje të Gjykatës, mund të heq dorë apo në mënyra tjera të zgjidh cilindo nga asetet e ndërmarrjes në vijim:

3.1. çdo aset problematik apo joprofitabil i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të

Likuidimit, nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës;

3.2. çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e ndërmarrjes, Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës.

4. Gjykata nxjerr vendim lidhur me kërkesën për lejim të dorëzuar nga Autoriteti i Likuidimit sipas paragrafit 3. më lart jo më vonë se dyzetepesë (45) pas datës në të cilën është dorëzuar kërkesa në Gjykatë dhe një kopje e saj t'i jetë dorëzuar Komitetit të Kreditorëve (nëse është themeluar nga Autoriteti i Likuidimit) dhe palët e tjera sipas udhëzimeve të Gjykatës. Çdo palë që kundërshton një kërkesë të tillë duhet të parashtrojë kërkesë për prapësim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ta kenë pranuar kërkesën. Autoriteti i likuidimit i ka pesëmbëdhjetë (15) ditë për t'iu përgjigjur shkresave të tilla të kundërshtimit pasi ta ketë pranuar një të tillë.

Neni 19

Veprimet specifike të Autoritetit të Likuidimit

1. Menjëherë pas datës së Vendimit për likuidim, Autoriteti i Likuidimit ndërmerr veprimet në vijim:

1.1. kryen shqyrtim të shpejtë të dokumentacionit në dispozicion dhe llogaritë vlerën totale të të gjitha obligimeve të ndërmarrjes bazuar në vlerësimet më të përafërta që rezultojnë nga shqyrtimi;

1.2. kontraktin shërbimet e ish punonjësve si specialistë, me qëllim të konfirmimit të besueshmërisë së informatave të ndërmarrjes.

2. Sapo të jetë praktikisht e arsyeshme pas datës së Vendimit për Likuidim, Autoriteti i Likuidimit ndërmerr të gjitha veprimet e duhura në rrethanat aktuale për të gjetur, marrë në posedim, plombuar, ruajtur, mbrojtur dhe aplikuar masa të arsyeshme të nevojshme për mirëmbajtje të aseteve të ndërmarrjes.

3. Autoriteti i Likuidimit lëshon njoftim për palët e treta që mbajnë apo kanë në posedim asete të ndërmarrjes duke kërkuar që ajo palë e tretë të ndërpresë posedimin dhe të dorëzojë asetin te Autoriteti i Likuidimit. Nëse është e nevojshme, Autoriteti i Likuidimit, në emër të Agjencisë, kërkon nga Gjykata urdhër për zbatimin e kësaj kërkesë. Nëse aseti në fjalë gjendet jashtë Kosovës, Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë nga një gjykatë tjetër që ka juridiksion mbi asetin dhe autoritet të zbatojë këtë kërkesë, apo Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë që Gjykata të lëshojë kërkesë për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar sipas paragrafit 2 të nenit 19 të rregullores së punës të Gjykatës, të përshkruar në Shtojcën e Ligjit për Dhomën e Posaçme⁷. Nëse zbatimi i kësaj kërkesë dëshmohej të jetë i pasigurt, jopraktik apo jo i shpejtë, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtrojë kërkesë me shkrim në Gjykatë, sipas paragrafit 4 të nenit 19, për autoritetin për të hequr dorë apo zgjidhur në mënyra tjera interesin e ndërmarrjes ndaj asetit.

⁷ Nga data 13 Korrik 2019, në rast të zbatimit të nenit 19.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, duhet referuar nenit 27 të Ligjit nr. nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, publikuar në Gazetën Zyrtare më 27 Qershor 2019, në fuqi nga 13 Korrik 2019, e jo më nenit 19.2 të Shtojcës së Ligjit të vjetër të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 06/L-086.

4. Nëse prona e ndërmarrjes gjendet në shtete tjera dhe nuk mund të realizohet, Autoriteti i Likuidimit kërkon nga Gjykata leje për të hequr dorë nga kjo pronë. Agjencia krijon regjistër të pronave të hequra dorë dhe këtë pronë e dorëzon te Shteti i Kosovës që të mbahet në mirëbesim. Nëse një pronë e ndërmarrjes në shtetet tjera realizohet nga qeveria e Kosovës, të hyrat nga ajo shitje e pronës do të transferohet te Agjencia për t'u mbajtur në mirëbesim për përfitim të përgjithshëm të kreditorëve të regjistruar dhe bartësve të regjistruar të interesit në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Për këtë qëllim, Autoriteti i Likuidimit mban regjistër të pronave të hequra dorë të ndërmarrjes dhe ekstrakti i këtij regjistri do t'i bashkëngjitet raportit final të Autoritetit të Likuidimit në mbyllje të rastit.

5. Autoriteti i Likuidimit, duke shfrytëzuar informatat më të mira të mundshme në dispozicion, përgatit një regjistër të të gjitha aseteve të ndërmarrjes (të prekshme të paprekshme) dhe detyrimeve të njohura (përfshirë detyrimet e mundshme), të çdo lloji apo përkrahimi. Ky regjistër kompletohet sa më parë që të jetë praktike dhe azhurnohet pa vonesa sapo që të shfaqen informatat e reja dhe kërkohen veprime, përfshirë informatat për pronën e mbledhur nga Autoriteti i Likuidimit në emër të ndërmarrjes apo të marrë nga ndërmarrja gjatë rrjedhës së punës së saj. Regjistri i të gjitha pasurive dhe detyrimeve nuk përfshin "mjetet pensionale" apo "të drejtat e fituara" të përkufizuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 për "Pensionet në Kosovë".

~~6. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së parë të publikimit të Njoftimit për Likuidim, Autoriteti i Likuidimit paraqet njoftim formal në pajtim me nenin 7 dhe 10 të kësaj Shtojce në gjykatat përkatëse, Regjistrin e Bizneseve Kosovare, Regjistrin e Pengjeve të Kosovës, Regjistrin e Hipotekave në Kosovë, Agjencinë Kadastrorë të Kosovës, bankën(at) e ndërmarrjes dhe Administratën Tatimore, si dhe këto organe janë përgjegjëse për të siguruar se kopja e atij njoftimi futet në dosje dhe regjistra të mbajtur nga ta në lidhje me ndërmarrjen apo asetet e saj. Ky njoftim do të përfshin referencë në këtë paragraf (6) dhe obligimin e institucionit në fjalë.~~

6. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së parë të publikimit të Njoftimit për Likuidim, Autoriteti i Likuidimit paraqet njoftim formal në pajtim me nenin 7 dhe 10 të Shtojcës së ligjit bazik në gjykatat përkatëse, Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare, Regjistrin e Pengjeve të Kosovës, Regjistrin e Hipotekave në Kosovë, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, bankën(at) e ndërmarrjes, Administratën Tatimore, Ofruesit e Shërbimeve Publike në nivel Qendror dhe Lokal. Këto organe janë përgjegjëse për të siguruar se kopja e atij njoftimi futet në dosje dhe regjistra të mbajtur nga ta në lidhje me ndërmarrjen apo asetet e saj. Ky njoftim do të përfshin referencë në këtë paragraf (6) dhe obligimin e institucionit në fjalë.

7. Gjykata nxjerr vendim lidhur me çdo kërkesë të dorëzuar nga Autoriteti i Likuidimit jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është dorëzuar kërkesa në Gjykatë dhe një kopje e saj t'jetë dorëzuar Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera sipas udhëzimit nga Gjykata. Çdo palë që kundërshton kërkesat e tilla duhet të parashtrijë kërkesë për prapësim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi ta ketë marrë kërkesën. Autoriteti i Likuidimit i ka pesëmbëdhjetë (15) ditë të përgjigjet në shkresën e kundërshtimit pasi ta ketë pranuar të njëjtën.

Neni 20

Pranimi dhe refuzimi i kontratave

1. Autoriteti i Likuidimit mund të pranojë apo të refuzojë kontratat e lidhura nga ndërmarrja para datës së Vendimit për Likuidim të cilat ende nuk janë përmbushur në tërësi nga pala tjetër, me kusht që refuzimi i Autoritetit të Likuidimit i kontratës së tillë i jep palës tjetër mundësi për të parashtruar Kërkesa të pasiguruara për dëme, ndërsa kërkesa e tillë kategorizohet dhe ka prioritetin të specifikuar sipas nënparagrafit 1.7 të paragrafit 1 të nenit 40 të kësaj Shtojce.

2. Nëse ndërmarrja ka dështuar apo ka shkelur një kusht substancial të kontratës, Autoriteti i Likuidimit mund ta pranojë kontratën vetëm nëse:

2.1. dështimi apo shkelja që mund të korrigojë është duke u korrigjuar; megjithatë, me kusht që dështimi apo shkelja të mos duhet të korrigojë nëse bazohen në statusin e insolvencës (paaftësisë së pagimit) të ndërmarrjes;

2.2. pala tjetër kompensohet në mënyrë adekuate për dëmet e shkaktuara nga ajo shkelje apo dështim; dhe

2.3. palës tjetër i janë dhënë siguri adekuate në lidhje me realizimin e obligimeve kontraktuale nga ndërmarrja në të ardhmen.

3. Nëse Autoriteti i Likuidimit pranon një kontratë, dhe më vonë Autoriteti i Likuidimit e refuzon atë kontratë, pala tjetër ka të drejtë të parashtrorë kërkesë për kompensim të dëmeve, e cila do të kategorizohet si Kërkesë për Shpenzime Administrative dhe ka prioritetin që i caktohet sipas pikës 1.3.5. të nën-paragrafit 1.3. të paragrafit 1. të nenit 40.

4. Shuma e dëmeve që mund të jetë objekt i Kërkesës sipas këtij neni përcaktohet në pajtim me dispozitat e kontratës dhe ligjit të aplikueshëm për përcaktimin e dëmeve të tilla.

5. Pavarësisht dispozitat kontraktuese që ndalojnë transferimin, Autoriteti mund të pranojë dhe të transferojë çdo kontratë të lidhur nga ndërmarrja. Nëse ndërmarrja ka shkelur kontratën apo ka dështuar në kontratë, transferimi mund të bëhet vetëm pasi që Autoriteti i Likuidimit t'i ketë përmbushur kushtet e saktësuara në nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2 të paragrafit 2 më lart dhe përfituesi i propozuar i transferimit t'i jep palës tjetër siguri adekuate për sa i përket realizimit të obligimeve kontraktuale në të ardhmen. Pas transferimit, ndërmarrja do të lirohet nga detyrimet për shkeljet pasuese të përfituesit të transferimit.

Neni 21

Anulimi i transaksionit

1. Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit apo një kreditori apo bartësi të interesit, Gjykata nxjerr urdhër për anulimin e çdo transferi, transaksioni apo kontrate që përfshin apo prek asetet apo kapitalin e ndërmarrjes të fituar gjatë periudhës 22 mars 1989 deri në datën e Vendimit për Likuidim (dhe hedh poshtë çdo Dëshmi të Kërkesës apo Dëshmi të Interesit të bazuar në të), nëse, duke pasur parasysh dëshmitë në dispozicion dhe rrethanat e asaj kohe, Gjykata përcakton në

mënyrë të arsyeshme se ai transfer, transaksion apo kontratë, apo pagesat apo furnizimet në lidhje me të:

1.1. janë bërë në vlerë më të vogël sesa vlera e drejtë;

1.2. kanë ulur vlerën totale të aseteve të ndërmarrjes;

1.3. kishin për qëllim apo për pasojë dëmtimin e interesave të kreditorëve;

1.4. kishin qëllim apo rezultuan në humbje, zvarritje apo pengim të aftësisë së kreditorëve për të mbledhur kërkesa përmes transferimit të aseteve të palë të treta gjersa pala e tretë ishte apo duhej të ishte në dijeni për atë qëllim apo ndikim;

1.5. ishin si rrjedhojë e një transaksioni me kreditorin, përmes së cilit kreditori ka fituar më tepër se sesa hisja proporcionale në asetet e ndërmarrjes dhe transaksioni ka ndodhur në kohë kur kreditori duhej të ishte në dijeni se ndërmarrja nuk ishte apo nuk do të ishte në gjendje t'i përmbush obligimet e saj;

1.6. ishin në kundërshtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së apo Rregulloret e Këshillit të Bashkimit Evropian lidhur me imponimin e sanksioneve ndërkombëtare, pavarësisht se ajo mund të jetë pranuar më vonë me vendim gjyqësor apo arbitrim; apo

1.7. kanë qenë të prira për t'u anuluar apo të qenë të pazbatueshme në bazë të dispozitave të nenit 36 apo një baze tjetër ligjore.

2. Transferimi për qëllim të këtij neni përfshin çfarëdo mënyrë (direkte apo indirekte, absolute apo të kushtëzuar, vullnetare apo jovullnetare) të bartjes ose transferit, shitjes, këmbimit, dhuratës, shpërndarjes, zgjidhjes, lënies peng, hipotekës apo të drejtave të tjera.

3. Gjykata nxjerr vendim për kërkesat e dorëzuara sipas paragrafit 1. jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është dorëzuar kërkesa në Gjykatë dhe një kopje e saj t'jetë dorëzuar Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera sipas udhëzimit nga Gjykata. Çdo palë që kundërshton kërkesat e tilla duhet të parashtojë kërkesë për prapësim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi ta kenë marrë kërkesën. Pala që dorëzon kërkesën i ka pesëmbëdhjetë (15) ditë të përgjigjet në shkresën e kundërshtimit.

Neni 22

Obligimi për të bashkëpunuar me Autoritetin e Likuidimit

Ndërmarrja, Menaxhmenti, punonjësit e ndërmarrjes, përfshirë ish punonjësit, si dhe të gjithë Personat e tjerë relevantë, përfshirë të gjitha autoritetet publike, bashkëpunojnë me Autoritetin e Likuidimit dhe sigurojnë qasje në të gjithë dokumentet dhe informatat që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe operacionet e ndërmarrjes dhe aseteve të saj, përfshirë dhe pa u kufizuar në to, të gjitha informatat rreth kërkesave, shumave të paguara, transferimeve apo tjetërsimeve të pronës dhe aseteve të ndërmarrjes dhe të gjitha pagesave, transferimeve apo veprimtarisë që ka të bëjë me Ndërmarrjen.

PJESA IV KREDITORËT, TAKIMET E KREDITORËVE DHE DËSHMITË E KËRKESAVE

Neni 23 Dëshmitë e kërkesës apo interesit

1. Formulari i Dëshmisë së kërkesës duhet t'i përfshijë informatat si në vijim:

~~1.1. emrin, adresën dhe informatat tjera të kontaktit të kreditorit të supozuar;~~

1.1. emrin, adresën dhe informatat tjera të kontaktit të kreditorit të supozuar, në të kundërtën do të konsiderohet si e papranueshme dhe si e tillë nuk do të hyjë për shqyrtim të mëtutjeshëm në proces të likuidimit;

1.2. shumën total monetare të kërkesës së pretenduar (së bashku me kamatën e mundshme të pretenduar të akumuluar të cekur ndaras) dhe përshkrimin e natyrës së Kërkesës duke identifikuar si dhe kur ka lindur kërkesa e pretenduar dhe duke saktësuar nëse Kërkesa është e drejtuar ndaj një asetit të veçantë të ndërmarrjes dhe nëse është e mundur nëse kërkesa synon nga ndërmarrja kryerjen e një obligimi të veçantë të ndryshëm nga pagesa në para;

1.3. përshkrimin e hollësishëm të veprimeve të mëparshme ligjore të ndërmarrja nga kreditori i supozuar për konfirmim apo mbrojtje të Kërkesës;

1.4. hollësitë lidhur me normën e konvertimit të valutës, nëse ka nevojë;

1.5. kopje të kontratave me shkrim dhe dokumenteve të tjera që kanë për qëllim vërtetimin e Kërkesës;

1.6. tiparet e kolateralit të mundshëm, vlerën e kolateralit, datën kur është dhënë dhe hollësitë e regjistrimit apo veprimet tjera të nevojshme për të paraqitur si të vlefshëm interesin e kreditorit në kolateral kundrejt palëve të treta; dhe

1.7. informatat tjera relevante në lidhje me Kërkesën që kreditori i supozuar dëshiron t'i dorëzojë.

2. Formulari i Dëshmisë së interesit duhet t'i përfshijë informatat në vijim:

~~2.1. emrin, adresën dhe informatat tjera të kontaktit të bartësit të supozuar të interesit;~~

2.1. emrin, adresën dhe informatat tjera të kontaktit të bartësit të supozuar të interesit, në të kundërtën do të konsiderohet si e papranueshme dhe si e tillë nuk do të hyjë për shqyrtim të mëtutjeshëm në proces të likuidimit;

2.2. natyrën e interesit të pretenduar dhe përshkrimin se si dhe kur është shfaqur interesi i pretenduar;

- 2.3. përshkrimin e hollësishëm të të gjitha veprimeve paraprake ligjore të ndërmarrja nga bartësi i supozuar i interesit për konfirmimin apo mbrojtjen e interesit të pretenduar;
 - 2.4. kopje të kontratave me shkrim dhe dokumenteve të tjera që kanë për qëllim vërtetimin e interesit të pretenduar;
 - 2.5. informata tjera relevante në lidhje me interesin e pretenduar që bartësi i supozuar i interesit dëshiron t'i dorëzojë.
3. Autoriteti i Likuidimit ka të drejtë të kërkoj nga personi që ka parashtruar Dëshmi të Kërkesës apo Dëshmi të Interesit të ofrojë informata apo dokumente shtesë të cilat Autoriteti i Likuidimit konsideron se janë të domosdoshme apo të përshtatshme për përcaktimin e vlefshmërisë së Kërkesës apo Interesit në fjalë.
 4. Për Kërkesat që nuk e kanë arritur afatin e pagesës, për qëllime të dorëzimit të Dëshmisë së Kërkesës, do të konsiderohet se ato e kanë arritur afatin e pagesës që nga data e Vendimit për Likuidim.
 5. Nga Agjencia apo pala e tretë që ka paguar kompensimin apo shpenzimet e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale do të kërkohet të dorëzojë Dëshmi të Kërkesës për ato pagesa vetëm nëse drejtpërsëdrejti kërkohej nga Gjykata. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk kërkohet të dorëzojë Dëshmi të Interesit për interesin pronësor të Republikës së Kosovës në ndërmarrje dhe/apo asetet e saj të përcaktuar me paragrafin 2. të nenit 159 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
 6. Autoriteti i Likuidimit mban regjistër të të gjitha Dëshmimeve të Kërkesave dhe Dëshmimeve të Interesit dhe të njëjtin do ta vë në dispozicion për inspektim, Kreditorët e regjistruar, apo palët tjera që potencialisht kanë interes të drejtpërdrejtë financiar në ndërmarrje. Duhet të bëhen rregullimet përkatëse për tu mundësuar këtyre Personave për shqyrtimin apo fotokopjimin e regjistrit gjatë orëve normale të punës.

Neni 24

Mbrojtja e interesave të kreditorëve

1. Kurdo pas Vendimit të Likuidimit, dhe pas ofrimit të dëshmimeve adekuate dhe përkatëse, kreditorët e regjistruar të një ndërmarrje mund të parashtrorjnë kërkesë në Gjykatë për lëshimin e një urdhri sipas të cilit afarizmi apo asetet e ndërmarrjes janë menaxhuar nga Autoriteti Likuidues në mënyrë që është padrejtësisht paragjyqese ndaj interesave të kreditorëve në përgjithësi, apo ndaj interesave të një pjese të kreditorëve, apo së paku ndaj interesave të kreditorit të regjistruar që ka parashtruar kërkesën; apo se ndonjë veprim apo gabim aktual apo i propozuar i Autoritetit Likuidues është apo mund të jetë padrejtësisht paragjyqes.
2. Gjykata do të merr vendim mbi të gjitha kërkesat e tilla jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas datës së parashtrimit të kërkesës para Gjykatës dhe dërgimit të një kopjeje të saj Autoritetit Likuidues, Komisionit të Kreditorëve (nëse ekziston një i tillë) dhe palëve tjera të autorizuara nga Gjykata. Autoriteti Likuidues mund të parashtrorjë kërkesë për prapësim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i kërkesës. Parashtruesi i kërkesës do të ketë pesëmbëdhjetë (15) ditë për t'iu përgjigjur kërkesave për prapësim.

Neni 25

Takimi i Kreditorëve

1. Autoriteti i Likuidimit mundet por nuk është i detyruar të mbajë një Takim të Kreditorëve.
2. Autoriteti i Likuidimit, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para Takimit të Kreditorëve të cilin Autoriteti i Likuidimit ka vendosur ta mbajë, i njofton për takimin të gjithë kreditorët që kanë parashtruar Dëshmi të Kërkesës në datën e Afatit për Dorëzimin e Kërkesave apo para asaj date; duke pasur parasysh që Autoriteti i Likuidimit – me përjashtim të Përfaqësuesve të Punonjësve – nuk është i obliguar t’ua dërgojë këtë njoftim kreditorëve punonjës që kanë parashtruar vetëm Dëshmi të Kërkesës të kategorizuar në nën-paragrafin 1.3 paragrafi 1 i nenit 40.
3. Takimi do të mbahet në ditë pune, me fillim brenda orarit të punës në një lokacion brenda Kosovës të caktuar nga Autoriteti i Likuidimit. Njoftimi saktëson datën, vendin dhe kohën e takimit.
4. Takimi i Kreditorëve kryesohet nga Autoriteti i Likuidimit që mund të ketë nevojë për pjesëmarrje të përfaqësuesve të AKP-së apo Ofruesve të Shërbimeve Profesionale.
5. Përveç Personave të cekur në paragrafin 4., në takim mund të marrin pjesë vetëm personat që kanë të drejtë në pranim të njoftimit sipas paragrafit 2. Personat e autorizuar që nuk kanë mundësi të marrin pjesë mund ta autorizojnë një përfaqësues në vendin e tyre. Këta Persona kanë të drejtë të ngrisin dhe diskutojnë çdo çështje që ka të bëjë me administrimin e likuidimit të ndërmarrjes.
6. Asnjë person tjetër përveç atyre të cekur në paragrafët 4. dhe 5. nuk mund të jenë të pranishëm në takim.
7. Autoriteti i Likuidimit, kohë pas kohe, mund të mbaj takime tjera të Kreditorëve të Regjistruar nëse konsideron se janë të nevojshme për t’i vërtetuar mendimet e Kreditorëve të Regjistruar. Njoftimi për takim, mbajtja dhe zhvillimi i takimit bëhen në pajtim me të njëjtat rregulla që qeverisin Takimin e Kreditorëve të cekur në paragrafët 2-6 më lart.

Neni 26

Komiteti i Kreditorëve

1. Autoriteti i Likuidimit mundet por nuk është i detyruar të krijojë një Komitet të Kreditorëve. Komiteti i Kreditorëve përbëhet nga një grup Personash që mund të konsiderohen si përfaqësues të të gjithë kreditorëve.
2. Komiteti i Kreditorëve i krijuar në këtë mënyrë përshin dy (2) Përfaqësues të Punonjësve dhe së paku tre (3) por jo më shumë se shtatë (7) kreditorë tjerë jo-punonjës që kanë parashtruar Dëshmi të Kërkesës në Autoritetin e Likuidimit brenda afatit për dorëzim të kërkesave. Nëse Dëshmi të Kërkesës kanë paraqitur një apo më shumë autoritete publike të Kosovës, Ministri i Industrisë dhe Tregtisë, Ministri i Financave apo përfaqësuesi i tij/saj përfshihen si kreditorë jo- punonjës në Komitetin e Kreditorëve.

3. Kreditorët me kërkesa të paplota apo të kontestuara nga Autoriteti i Likuidimit nuk mund të shërbejnë si anëtarë të komitetit të kreditorëve. Këta kreditorë kualifikohen për anëtarë të komitetit të kreditorëve pas pranimit të kërkesave të tyre apo me vendim Gjyqësor në favor të tyre në rast kontesti.

4. Anëtarët e Komitetit të Kreditorëve kanë të drejtat dhe obligimet si në vijim:

4.1. Të drejtën për të pranuar kopje të raporteve të Autoritetit të Likuidimit, raporte të tilla autoriteti i likuidimit do të sigurojë për çdo vit;

4.2. Të drejtën për të kërkuar nga Autoriteti i Likuidimit përgjigjen e pyetjeve që kanë të bëjnë me ndërmarrjen;

4.3. Të drejtën për të kërkuar nga Autoriteti i Likuidimit inicimin e anulimit të transaksionit sipas nenit 21 apo për refuzimin e një Kërkesë sipas nenit 36 të kësaj Shtojce;

4.4. Obligimin për të ndarë me të gjithë Kreditorët e Regjistruar qasjen në informatat e siguruara lidhur me ndërmarrjen;

4.5. Nëse kërkohet nga Autoriteti i Likuidimit, të veprojë si grup konsulent për ndërmarrjen dhe Autoritetin e Likuidimit dhe të ndihmojë ndërmarrjen dhe Autoritetin e Likuidimit në proceset e tyre vendimmarrëse;

4.6. Takimi me kreditorët mund të thirret me iniciativë të kreditorëve, Autoritetit të Likuidimit, apo kryesuesve të komitetit të kreditorëve. Kreditorët që iniciojnë takimin mbulojnë të gjitha shpenzimet për organizimin e takimit;

4.7. Komiteti i Kreditorëve vendos për Kryesuesin nga radhët e tyre përmes votimit me shumicë të thjeshtë;

4.8. Shpenzimet që kanë të bëjnë me takimet e thirrura me iniciativë të Autoritetit të Likuidimit mbuloohen nga të hyrat e pronës së ndërmarrjes;

4.9. Komiteti i Kreditorëve do të ketë të drejta dhe obligime të tjera që ju përcaktohen me këtë ligj apo me urdhër të Gjykatës.

5. Autoriteti i Likuidimit mund të largojë një anëtar të Komitetit të Kreditorëve nëse Autoriteti i Likuidimit ka baza të arsyeshme për të besuar se ai largim ishte i domosdoshëm apo i dëshirueshëm. Këto baza mund të përfshijnë, mes tjerash, ekzistimin e fakteve që mund të dëshmojnë se ai anëtar është duke e përdorur statusin e anëtarit në Komitetin e Kreditorëve për të minuar procesin e likuidimit apo për të dëmtuar ndërmarrjen. Largimi i tillë gjithashtu mund të kërkohet nga shumica e anëtarëve të tjerë të Komitetit të Kreditorëve.

PJESA V

PRONA E NDËRMARRJES NË LIKUIDIM

Neni 27

Prona e ndërmarrjes në likuidim

1. Vendimi për Likuidim krijon një pronë likuide të përbërë nga të gjitha asetet në pronësi ose posedim të ndërmarrjes në kohën kur është miratuar vendimi, përfshirë si në vijim, por pa u kufizuar në to:

- 1.1. të gjitha pronat e luajtshme, të paluajtshme, kudo që ndodhen, qoftë në posedim apo në kujdestari të ndërmarrjes apo palës së tretë;
- 1.2. kërkesat dhe veprimet ligjore ndaj palëve të treta;
- 1.3. të hyrat nga veprimet për rikthimin e transferimeve mashtruese apo preferenciale;
- 1.4. trashëgiminë, sigurimet dhe fondet tjera të pranuar brenda 6 muajve nga Data e Likuidimit;
- 1.5. qiranë, të ardhurat dhe të hyrat e krijuara nga përdorimi i pronës së ndërmarrjes apo operimit të biznesit të ndërmarrjes;
- 1.6. të drejtat kontraktuese, licencat apo të drejtat tjera të krijuara apo të dhuruara me ligj; dhe
- 1.7. të gjitha asetet tjera të identifikuar nga Autoriteti i Likuidimit.

Neni 28

Kufizimet në transferimin e pronës

1. Që nga momenti i miratimit të Vendimit për Likuidim, shitja, zgjidhja, tjetërsimi, transferimi apo inicimi i qiradhënies së një prone të ndërmarrjes, në tërësi apo pjesërisht, përfshirë transferet për përmbushjen e obligimeve ekzistuese, apo krijimin e garancive apo interesave hipotekare kundrejt pronës së ndërmarrjes që nuk është iniciuar nga Autoriteti i Likuidimit ndalohet pa urdhër të Gjykatës.
2. Të gjitha transferet për përmbushjen e obligimeve ekzistuese, apo krijimi i garancive apo interesave hipotekare kundrejt pronës së ndërmarrjes ndalohen pa aprovim të Gjykatës, përveç për shitjen apo transferimin mallrave në rrjedhën e rregullt të operimit të biznesit të ndërmarrjes nëse ato operacione biznesi vazhdojnë të funksionojnë.

Neni 29

Mallrat në transit në të cilat ndërmarrja ende nuk ka fituar të drejta pronësie

1. Nëse mallrat që i janë shitur ndërmarrjes janë në transit në momentin e Vendimit të Likuidimit,

dhe ndërmarrja ende nuk ka fituar të drejta pronësore mbi ato mallra, shitësi mund të kërkojë kthimin e mallrave, gjersa shitësi bart të gjitha shpenzimet e lidhura me kthimin, si dhe ripaguan paradhëniet e bëra nga ndërmarrja.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, Autoriteti i likuidimit mund të kërkojë dorëzimin e mallrave, nëse Autoriteti i Likuidimit detyron ndërmarrjen të paguaj tërë shumën kontraktuese të transaksionit.

Neni 30

Prona e mbajtur në emër të palëve të treta

1. Nëse ndërmarrja është agjent apo broker i një pale të tretë të autorizuar të pranojë apo shesë pronat në pronësi të palëve të treta, ajo palë mund të shfuqizojë statusin si broker apo administrues dhe të kërkojë kthimin e pronës së mbajtur në kujdestari të ndërmarrjes, duke dorëzuar një kërkesë me shkrim në lidhje me të te Autoriteti i Likuidimit.

2. Nëse në kohën e kërkesës për kthim të pronës është i pamundur kthimi i tërë apo një pjese të pronës të mbajtur në kujdestari të ndërmarrjes në emër të palës së tretë, pala e tretë ka të drejtë të parashtrojë kërkesë në çmim të kontratës. Nëse është i pamundur përcaktimi i çmimit kontraktues, në fuqi do të jetë çmimi i shitjes sipas Vendimit për Likuidim.

3. Nëse gjatë kohës së kërkesës për kthim të pronës ndërmarrja posedon pronë që duhet shitur mirëpo specifikat e saj i nënshtrohen rënies së shpejtë dhe drastike në vlerë, siç është rasti i mallrave të prishshme, pronari ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për çmimin kontraktues të pronës.

4. Çdo pronë e kthyer sipas këtij neni ekzekutohet në shpenzim të personit që ka kërkuar kthimin.

Neni 31

Të hyrat nga shitjet e pronës

Të hyrat e pranuar nga shitja e pronës së ndërmarrjes, në pajtim me këtë ligj, janë pronë e ndërmarrjes dhe mbrohen dhe regjistrohen në mënyrë të rregullt nga Autoriteti i Likuidimit.

Neni 32

Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës

Të hyrat e pranuar nga shfrytëzim i pronës së Ndërmarrjes (siç janë qiratë) janë pronë e ndërmarrjes në likuidim dhe mbrohen dhe regjistrohen nga Autoriteti i Likuidimit.

Neni 33

Shpenzimet e shitjes

Shpenzimet e shitjes së pronës së siguruar mbulohen në radhë të parë nga të hyrat prej shitjes së pronës së siguruar.

Neni 34

Mbrojtja adekuate e asetëve që janë objekt i kërkesave të siguruara

1. Nëse prona e ndërmarrjes është e siguarar me anë të garancisë, pengut apo interesit kapital, dhe nëse kreditorit që është bartës i garancisë, pengut apo interesit kapitali i ndaloheq që të ushtrojë të drejtat e tij për marrjen nën kontroll, posedimin apo shitjen e pronës për shkak të Vendimit të Likuidimit, kreditori i siguarar ka të drejtë në mbrojtje adekuate të pronës së siguarar për ta mbajtur gjendjen dhe vlerën e saj ashtu siç ishte në kohën kur Vendimi për Likuidim hyri në fuqi.
2. Nëse prona që është objekt i interesit kapital nuk gëzon mbrojtje adekuate, kreditori i siguarar mund të parashtrrojë kërkesë me shkrim te Autoriteti i Likuidimit për mbrojtje adekuate.
3. Nëse Autoriteti i Likuidimit dështon në mbrojtjen e pronës, kreditori i kapitalit ka të drejtë të dorëzojë kërkesë në Gjykatë e cila duhet të nxjerrë aktvendim lidhur me kërkesën për mbrojtje adekuate brenda njëzet (20) ditëve pas parashtrimit.

PJESA VI

KËRKESAT, PRIORITETET, SHPËRNDARJA

Neni 35

Njoftimi për kreditorin dhe Afati për parashtrimin e kërkesave

1. Në pajtim me nenin 7 të kësaj Shtojce, Autoriteti i Likuidimit publikon njoftim në pajtim me Dispozitat për shpallje duke u bërë thirrje të gjithë kreditorëve dhe bartësve të interesit që t'i parashtrajnë Dëshmitë e tyre të Kërkesës dhe të Interesit.
2. Nëse Autoriteti i Likuidimit është duke shqyrtuar nëse një kërkesë është parashtruar si duhet brenda afatit përkatës kohor, ai trajton dërgimin e kërkesave në Agjenci si pezullim të llogaritjes së periudhës kohore pas asaj dërgese.
3. Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë Dëshminë e Kërkesës apo Interesit të dorëzuar pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dëshmia e Kërkesës apo Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave.

Neni 36

Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta

~~1. Autoriteti i Likuidimit refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë e Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të Gjykatës.~~

1. Pas përcaktimit të pranueshmërisë së kërkesave të ndërlidhura me nenin 23.1.1 dhe të shtojcës së këtij ligji, Autoriteti i Likuidimit merr në shqyrtim dhe refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë meritorë të Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse

refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të Gjykatës.

2. Pa kufizuar fushëveprimin apo zbatueshmërisë e paragrafit 1 më sipër, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:

2.1. kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme;

2.2. dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese;

2.3. ndonjë aspekt i dokumentacionit të paraqitur është mashtrues apo ka dëshmi të mira dhe substanciale për të besuar se Kërkesa apo interesi i pretenduar është mashtrues; apo

2.4. ka arsye për të besuar se transaksioni:

2.4.1. nuk është aprovuar përmes procedurave të rregullta të brendshme të Ndërmarrjes;

2.4.2. është ekzekutuar në emër të Ndërmarrjes nga personi pa autoritet të vërtetë ligjor;

2.4.3. nuk do të ishte aprovuar nëse do të ishte parashtruar për aprovim të rregullt të brendshëm, përfshirë edhe kontratat që do të duhej të aprovohej nga Menaxhmenti apo një Zyrtar i Ndërmarrjes në kohën përkatëse, mirëpo të cilat nuk janë aprovuar;

2.4.4. në kohën përkatëse, është lidhur në kundërshtim me obligimin fiduciar apo obligimet tjera ndaj Ndërmarrjes apo palës së tretë nga Menaxhmenti apo Zyrtari sipas ligjit në fuqi në atë kohë; apo

2.4.5. ishte në kundërshtim me rregulloren e nxjerrë nga OKB-ja apo rregullore apo akte të ngjashme të nxjerra nga një organ i autorizuar nga Bashkimi Evropian; dhe, në secilin rast të saktësuar në pikët 2.4.1 – 2.4.5 më lart, kreditori apo kërkuesi i interesit ishin në dijeni apo, gjatë ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm profesional, do të duhej të ishin në dijeni të shkeljes, cenimit apo mungesës së autoritetit në fjalë.

2.5. në kohën që transaksioni është lidhur kreditori ishte në dijeni apo, gjatë ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm profesional, do të duhej të ishte në dijeni se Ndërmarrja ishte insolvente dhe se transaksioni ka rezultuar pasi që kreditori është vënë në pozitë më të favorshme sesa kreditorët e tjerë;

2.6. transaksioni është bërë në vlerë që është materialisht më e ulët sesa vlera aktuale e tregut në atë kohë;

2.7. pagesa apo furnizimi në lidhje me transaksionin ishte në shkelje të një apo më shumë rezolutash të Këshillit të Sigurimit të OKB-së apo Rregulloret e Këshillit të Bashkimit Evropian lidhur me imponimin e sanksioneve ndërkombëtare; apo

2.8. kërkesat që kanë të bëjnë me transaksionin që është kryer jashtë Kosovës:

2.8.1. ka të bëjë me një subjekt, apo subjekt apo njësi biznesi të supozuar e cila, në kohën e Vendimit efektiv për Likuidim, menaxhohet ndaras nga veprimtaria e ndërmarrjes në Kosovë; dhe

2.8.2. autoriteti i Likuidimit ka përcaktuar se nuk është i mundur zbatimi i marrjen nën kontroll në emër të ndërmarrjes i pronës apo asetëve të atij subjekti. Të gjitha transaksionet e tilla të mbyllura në emër të ndërmarrjes përfshin transaksionet qëllimi afarist i të cilave është kufizuar në subjektin e pavarur apo njësinë e biznesit.

Neni 37

Llogaritja dhe kompensimi i kërkesave

1. Dispozitat e këtij neni kanë efekt superior mbi dispozitat e mundshme kontradiktore të kontratave, zgjidhjeve, marrëveshjeve, aktgjykimeve apo rregullimeve tjera të lidhura nga Ndërmarrja apo në emër të saj.

2. Kërkesat për para që janë të dhëna në valutë tjetër, dhe jo në Euro, konvertohen në Euro me anë të normës së këmbimit të datës së Vendimit të Likuidimit. Kërkesat për para të dhëna në valutë që më nuk ekziston apo që është zëvendësuar me një valutë tjetër para datës së nxjerrjes së Vendimit të Likuidimit, do të konvertohen në valutën apo vulat pasardhëse duke shfrytëzuar normën e këmbimit që ishte në fuqi në kohën kur valuta është zëvendësuar dhe pas kësaj date do të date do të shndërrohen në Euro, në bazë të normës së këmbimit që ka qenë në fuqi në datën e lëshimit të Vendimit të Likuidimit.

3. Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

4. Menjëherë pas Afatit për parashtrimin e kërkesave, Autoriteti i Likuidimit vlerëson vlefshmërinë, shtrirjen dhe prioritetin e kërkesave dhe pengjeve apo kolateraleve të ndërlidhura të paraqitura ndaj Ndërmarrjes dhe njofton kërkesuesit në fjalë lidhur me rezultatet e atij vlerësimi; megjithatë, me kusht që:

4.1. kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi; dhe

4.2. garancitë dhe hipotekat janë të vlefshme vetëm nëse janë të regjistruara në pajtim me ligjin e aplikueshëm përkatës.

5. Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë informata dhe dëshmi shtesë nëse i konsideron si të nevojshme për ta kryer vlerësimin.

6. Nëse Autoriteti i Likuidimit refuzon, tërësisht apo pjesërisht, apo zvogëlon shumën e kërkesës së parashtruar, ai duhet të njoftojë kreditorin e prekur me shkrim, duke ofruar shpjegimet për refuzim apo zvogëlim të kërkesës.

7. Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe moskërkimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

8. Gjykata nxjerr vendim lidhur me kërkesën e parashtruar nga kreditori i prekur jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë, pas datës në të cilën kërkesa është dorëzuar në Gjykatë dhe pasi një kopje e saj t'i jetë dorëzuar Autoritetit të Likuidimit, Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera sipas udhëzimit të Gjykatës.

9. Përveç bazave tjera për kundërshtim të Kërkesës, Autoriteti i Likuidimit gjithashtu ka të drejtë, pa kufizime, që të:

9.1. konvertojë, tërësisht apo pjesërisht, çdo Kërkesë të bazuar në kontratë në kërkesë për kompensim monetar;

9.2. kundërshtojë një Kërkesë, tërësisht apo pjesërisht, bazuar në faktin që Kërkesa është përmbushur në mënyra tjera; dhe

9.3. kundërshtojë Kërkesën, tërësisht apo pjesërisht, sipas nevojës për të mbuluar shumën e kërkesës për të cilën kërkuesi që i detyrohet ndaj ndërmarrjes, me kusht që:

9.3.1. ka pasur marrëveshje reciproke ndërmjet Ndërmarrjes dhe Personit që parashtron Kërkesën apo paraardhësve të këtyre personave që kanë interes;

9.3.2. shumat në fjalë përbëjnë shumën të likuiduar;

9.3.3. shumat e detyruara në fjalë nuk kanë rrjedhur përmes caktimit apo transferimeve tjera si rezultat i transaksionit që është bërë brenda periudhës tre (3) muajore menjëherë pas datës së Vendimit për Likuidim; dhe

9.3.4. shumat në të kishin qenë të detyrueshme dhe të pagueshme para datës së Vendimit të Likuidimit.

Neni 38 **Kërkesat e siguruara**

1. Kërkesat e siguruara me anë të garancisë, siç është pengu, zotimi, pagesa, hipoteka apo siguri tjera mbi një pronë apo aset të ndërmarrjes (Kërkesë e Siguruar) nuk parandalojnë Autoritetin e

Likuidimit të tjetërsojë apo që në mënyra tjera të ushtrojë kompetencat e tij ndaj një Personi të tretë, apo ta parandalojë atë, nga marrja e asaj prone apo asetit të pagarantuar dhe të pasiguar, me kusht që shitja e tillë apo ushtrimi i kompetencave nga ana e Autoritetit të Likuidimit t'i njoftohet kreditorit.

2. Në rast se prona apo asetit i garantuar tjetërsohen apo në mënyra tjera bëhen subjekt i ushtrimit të kompetencave të Autoritetit të Likuidimit, Kërkesa e Siguruar e kreditorit ka prioritet të njëjtë sikur që do të kishte në kuptim të pronës apo asetit që është shitur apo që është bërë subjekt i ushtrimit të kompetencave të Autoritetit të Likuidimit nëse Autoriteti i Likuidimit i ka ndërmarrë këto veprime për qëllimin e vetëm të gjenerimit të të hyrave për shpërndarje te kreditorët.

3. Në rast se shitja apo ushtrimi i kompetencave të Autoritetit të Likuidimit ndaj pronës apo asetit të garantuar ka gjeneruar, apo pritet të gjenerojë, fonde likuide që janë të pamjaftueshme për të përmbushur Kërkesën e Siguruar, pjesa e Kërkesës së Siguruar që mbetet apo që pritet të mbetet e papërmbushur pranohet si Kërkesë e pasiguar.

Neni 39

Lista përfundimtare e Kërkesave

1. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas vlerësimit të të gjitha Kërkesave, përfshirë kundërshtimet ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit nga kreditori i prekur në lidhje me refuzimin apo zvogëlimin e Kërkesës sipas nenit 37, Autoriteti i Likuidimit përpilon listën përfundimtare të Kërkesave, duke e cekur shumën dhe statusin e tyre në pajtim me kategoritë prioritare të paraqitura në nenin 40 të këtij ligji.

2. Një kopje e listës përfundimtare të Kërkesave postohet në faqen e internetit të AKP-së dhe dorëzohet në Komitetin e Kreditorëve (nëse ekziston) dhe vihet në dispozicion për kreditorët që mund ta marrin pas dorëzimit të kërkesës në Autoritetin e Likuidimit.

Neni 40

Prioritetet e kërkesave dhe interesave

1. Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim:

1.1. kostot e shitjes apo realizimit në mënyra tjera të pronës apo aseteve të ndërmarrjes;

1.2. kredia e siguruar pas Kërkesës për Riorganizim e shkaktuar në pajtim me nenin 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 ose Ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara, cilido që është në fuqi në atë kohë, në atë masë që kredia të jetë aprovuar nga Gjykata. Ky prioritet ka të bëjë vetëm me të hyrat nga shitja apo transferimi në mënyra tjera i aseteve që sigurojnë kredinë;

1.3. kërkesat prioritare në renditjen në vijim:

1.3.1. shpenzimet e Gjykatës;

- 1.3.2. shpenzimet e Autoritetit të Likuidimit dhe këshilltarëve mbështetës;
 - 1.3.3. shpenzimet e Autoritetit të Likuidimit të nevojshme për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe asetëve të ndërmarrjes;
 - 1.3.4. shpenzimet për operimin e vazhdueshëm të ndërmarrjes pas vendimit të Agjencisë apo Gjykatës për të filluar procedurat e likuidimit; dhe
 - 1.3.5. të gjitha Kërkesat për Shpenzimet Administrative të shkaktuara gjatë riorganizimit apo gjatë procedurave të likuidimit.
- 1.4. kërkesat e siguruara deri në masën e realizuar nga asetet që sigurojnë kërkesat e tilla në shumën e atyre Kërkesave të siguruara dhe Kërkesave tjera;
 - 1.5. kërkesat bazuar në pronësinë e asetëve specifike përfshirë pasuritë e patundshme;
 - 1.6. kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim:
 - 1.6.1. kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person;
 - 1.6.2. kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.
 - 1.7. kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë;
 - 1.8. kërkesat e pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve apo partnerëve në ndërmarrje.
2. Kërkesat brenda të njëjtës kategori apo të njëjtës renditje radhiten në mënyrë të barabartë pavarësisht kohës kur janë paraqitur.
 3. Kërkesat do të përmbushen sipas prioritetit sipas kategorisë dhe renditjes të përcaktuar në këtë nen. Pagesat për përmbushje të Kërkesave do të bëhen në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 41 të këtij ligji dhe i ndjekin procedurat e Autoritetit të Likuidimit në pajtim me politikat financiare të Agjencisë të nxjerra në pajtueshmëri me nenin 15 të Ligjit për AKP-në.

Neni 41 **Përmbushja e kërkesave dhe interesave**

1. Kërkesat dhe interesat përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë të përcaktuar në nenin 40 të kësaj Shtojce.

2. Përbushja e kërkesave dhe interesave që i përkasin një kategorie pasuese të prioritetit më të ulët mund të iniciohen vetëm pas përbushjes së plotë dhe të tërësishme të Kërkesave të kategorisë së mëhershme të prioritetit më të lartë.

3. Nëse resurset janë të mjaftueshme për të përbushur të gjitha kërkesat e një kategorie të caktuar, duke përfshirë mbulimin për rezervimet e bëra nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo renditje, Autoriteti i Likuidimit mund të propozojë shpërndarjen e përkohshme në këto kategori të kreditorëve para Bordit.

4. Nëse resurset janë të pamjaftueshme për të përbushur tërësisht të gjitha Kërkesat apo interesat e një kategorie apo niveli të caktuar, përfshirë mbulimin për rezervimet e Autoritetit të Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo niveli, Kërkesat e asaj kategorie apo niveli përbushen në proporcion me shumën e çdo Kërkese, përfshirë kërkesat për të cilat Autoriteti i Likuidimit ka bërë rezervime.

Neni 42

Fondet e rezervuara

~~1. Me aprovim të Bordit, fondet Likuide, paratë apo asetet e tjera mund të ndahen nga Autoriteti i Likuidimit në llogari të ndarë të dorëzarisë (escroë) të mbajtur nga agjenti i dorëzarisë i emëruar nga Bordi për përbushje të:~~

~~2. Kërkesave që janë në kontestim dhe që ende nuk janë zgjidhur nga Gjykata;~~

~~3. Kërkesave për pagesa që janë subjekt i shpengimit për të cilin duhet të dorëzohen dokumentet, identifikimet apo kuponët, përfshirë letrat me vlerë, obligacionet, apo instrumente të ngjashme;~~

~~4. Shpenzimet e ardhshme në lidhje me mirëmbajtjen e pronës apo asetëve të caktuara apo të ndërmarrjes, dhe~~

~~5. Kërkesat e ardhshme të cilat do të paraqiten me siguri por që në kohën e Afatit për Parashtrimin e Kërkesave nuk ishin të konstatueshme.~~

Neni 42

Fondet e rezervuara

1. Me aprovim të Bordit, fondet likuide, paratë apo asetet e tjera mund të ndahen nga Autoriteti i Likuidimit në llogari të ndarë të dorëzarisë të mbajtur nga Agjencia për përbushje të:

1.1. Kërkesave që janë në kontestim dhe që ende nuk janë zgjidhur nga Gjykata;

1.2. Kërkesave për pagesa që janë subjekt i shpengimit për të cilin duhet të dorëzohen dokumentet, identifikimet apo kuponët, përfshirë letrat me vlerë, obligacionet, apo instrumente të ngjashme;

1.3. Shpenzimet e ardhshme në lidhje me mirëmbajtjen e pronës apo asetëve të caktuara apo

të ndërmarrjes; dhe

1.4. Kërkesat e ardhshme të cilat do të paraqiten me siguri, por që në kohën e Afatit për Parashtrimin e Kërkesave nuk ishin të konstatueshme.

2. Përjashtimisht nga dispozitat e parapara në këtë nen, Agjencia mund të llogaritë këto fonde të dorëzanië si pjesë përbërëse e Fondeve të Përkohshme të cilat do të trajtohen sipas dispozitave të këtij ligji, me kusht që Agjencia të mbaj në dorëzani njëzet e pesë përqind (25%) të shumë së vlerës së ankesave të dorëzuara në Dhomën e Posaçme ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit për kërkesat kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore.

PJESA VII MBYLLJA E RASTIT TË LIKUIDIMIT

Neni 43 Raporti përfundimtar

~~1. Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron raportin përfundimtar Gjykatës.~~

1. Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit.

2. Raporti përfundimtar përmban si në vijim:

2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera;

2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme;

2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara, duke shënuar në mënyrë të qartë shumat e shpërndara apo pronën e transferuar për përmbushjen e tërësishme apo pjesëshme të secilës;

2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

~~3. Autoriteti i Likuidimit dërgon njoftim të aprovimit të Raportit Përfundimtar nga ana e Gjykatës te kreditorët, komiteti i kreditorëve (nëse ekziston) brenda pesë (5) ditëve pas pranimit të aprovimit të Gjykatës për mbylljen e rastit të likuidimit. Njoftimi përmban ose vetë Raportin, ose një përmbledhje të raportit me kusht që raporti i plotë të jetë në dispozicion për inspektim për palët e interesuara dhe se kopja e raportit të jetë dërguar te kreditorët që e kanë kërkuar atë. Raporti përfundimtar postohet në faqen e internetit të AKP-së.~~

3. Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjensisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes.

4. Gjykata sipas detyrës zyrtare, pas shqyrtimit mund të kundërshtojë Raportin Përfundimtar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dorëzimi. Nëse dërgohet njoftimi për kundërshtim, Autoriteti i Likuidimit përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë në Gjykatë brenda tridhjetë (30) ditëve pas mocionit të gjykatës apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga Gjykata.

Neni 44

Mbyllja e rastit

1. Përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2. dhe 3. më poshtë, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

2. Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, në çdo fazë të procedurës, nëse përcaktohet se të Hyrat në fjalë janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e Kërkesave prioritare të përcaktuara në nenin 40, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1 të kësaj Shtojce, Gjykata nxjerr vendim që lejon mbylljen e rastit të likuidimit.

3. Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, nëse asnjë kreditor nuk ka parashtruar kërkesë brenda Afatit të Fundit për Parashtrimin e Kërkesave, Gjykata nxjerr vendim për lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit.

Neni 45

Pasojat e mbylljes së rastit

Pas mbylljes së rastit të likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce, ndërpritet ekzistimi i Ndërmarrjes dhe Agjencia lëshon njoftim me shkrim lidhur me këtë për Komunën dhe institucionet dhe autoritetet publike të specifikuara në nenin 19.6.

Neni 46

Pushimi i autoritetit të likuidimit

1. Në urdhrat për mbyllje të procedurës së Likuidimit, Gjykata përfshin procedurën për:

1.1. lirim të Autoritetit të Likuidimit nga detyrat tjera në lidhje me Ndërmarrjen dhe procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e shpërndarjeve përfundimtare të Autoritetit të Likuidimit që ende nuk kanë hyrë në fuqi; dhe

1.2. aprovimin e pagesës përfundimtare të kompensimit dhe shpenzimeve të papaguara të Autoritetit të Likuidimit.

2. Urdhrat e tillë të Gjykatës nuk kufizojnë përgjegjësinë e Autoritetit të Likuidimit për veprime apo lëshime joligjore gjatë mandatit të Autoritetit të Likuidimit.

Neni 47

Shuarja e borxheve

Pas mbylljes së rastit të likuidimit nga ana e Gjykatës sipas nenit 44 të kësaj Shtojce, të gjitha Kërkesat të cilat ndërmarrja detyrohet t'i mbulojë shuhen me ligj dhe çdo veprim për të inkasuar borxhe të tilla të shuara ndalohet, përveç nëse Gjykata e urdhëron atë para mbylljes apo në urdhrin për mbylljen e rastit të Likuidimit.

PJESA VIII

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 48

Udhëzimet e Gjykatës

1. Në çdo kohë gjatë procedurës së Likuidimit, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtrojë kërkesë me shkrim për të kërkuar nga Gjykata udhëzime në lidhje me dispozita të ligjit, përfshirë çështjet e pajtueshmërisë me këtë Ligj. Autoriteti i Likuidimit në të njëjtën kohë i siguron një kopje të kërkesës së tillë Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera të interesit sipas udhëzimit të Gjykatës. Gjykata lëshon vendim lidhur me këtë kërkesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas dorëzimit.
2. Pas pranimit të kërkesës sipas paragrafit 1 më lart, Gjykata njofton palën e prekur drejtpërsëdrejti nga kjo kërkesë dhe i mundëson palës të parashtrojë shkresë në Gjykatë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të njoftimit.
3. Gjykata mund të nxjerrë urdhër, proces apo aktgjykim që është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm apo i përshtatshëm për t'i zbatuar dispozitat e këtij ligji apo për të shtyrë përpara likuidimin e një Ndërmarrje.
4. Asnjë dispozitë e këtij ligji që përcakton ngritjen e një çështjeje nga cilado palë nuk parandalon Gjykatën që, sipas detyrës zyrtare apo me vetë-iniciativë, të ndërmer veprime apo përcaktime të nevojshme apo të përshtatshme për të zbatuar apo realizuar urdhrat apo rregullat e Gjykatës, apo për të parandaluar abuzimin e procesit.

Neni 49

Njoftimet dhe shpalljet publike

~~1. Të gjitha njoftimet formale sipas këtij Ligji publikohen, së paku, si në vijim;~~

1. Të gjitha njoftimet formale sipas shtojcës së ligjit bazik publikohen, së paku, si në vijim:

1.1. në serbisht dhe shqip në gazetata me tirazh më të madh në Kosovë;

1.2. në serbisht në një apo më shumë gazeta të gjuhës serbe me tirazh të madh në Serbi dhe Mal të Zi, nëse Autoriteti i Likuidimit konsideron se është e nevojshme; dhe

1.3. në një publikim në gjuhën angleze që ka tirazh të madh në Evropë, nëse nga Autoriteti i Likuidimit konsiderohet e nevojshme për njoftimin e kreditorëve.

2. Versionet në gjuhë të tjera të njoftimeve specifike publikohen në të njëjtën kohë sipas zbatueshmërisë në pajtim me rrethanat e caktuara.

Neni 50

Gjuha e dokumenteve kryesore

1. Dëshmitë e Kërkesës dhe Dëshmitë e Interesit, si dhe të gjitha dokumentacionet mbështetëse, duhet të dorëzohen në shqip apo serbisht. Çdo komunikim pasues me Autoritetin e Likuidimit mund të bëhet në njërën nga gjuhët e sipërpërmendura.

2. Dokumentet standarde të komunikimit formal, ftesat dhe formularët e përgatitur nga Autoriteti i Likuidimit duhet të hartohen dhe të jenë në dispozicion në shqip, serbisht dhe anglisht.

PJESA IX

SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 51

Parashtrimi i dokumenteve të rrejshme të kërkesës

1. Çdo Person që me qëllim jep deklarata materialisht të rrejshme apo mashtruese, me gojë apo me shkrim, përkitazi me procedurat e kryera sipas këtij ligji, apo që me qëllim ndihmon apo nxit një person tjetër të kryej akt të tillë ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë (100.000) Euro për secilin rast. Në rast të personit fizik, ky person mund t'i nënshtrohet edhe ndjekjes penale në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Kodit Penal.

2. Çdo Person që me qëllim parashtron Kërkesë të rrejshme apo dokumente të rrejshme apo jep deklarata të rrejshme para Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës në procedura sipas këtij Ligji, ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë (100.000) Euro për secilin rast. Në rast të personit fizik, përfshirë zyrtarë dhe drejtorë të personave juridikë, këta persona mund t'i nënshtrohen edhe ndjekjes penale në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Kodit Penal.

Neni 52

Përvetësimet e paligjshme dhe fshehja e aseteve

1. Çdo person që vepron në cilësi të një anëtari të Autoritetit të Likuidimit, apo që angazhohet për të punuar në mbikëqyrje të Autoritetit të Likuidimit, Agjencisë apo Ndërmarrjes, që me qëllim bën përvetësim të paligjshëm, shkatërron, vjedh, në mënyrë direkte apo indirekte, dokumente, prona apo asete të Ndërmarrjes do të mbahet përgjegjës për shumën e mjetit në fjalë si dhe ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë (100.000) Euro për secilin rast. Në rast të personit fizik, ai person mund të ndiqet penalisht në pajtim me Kodin Penal.

2. Çdo person që me qëllim transferon, fsheh apo dështon të paraqes dokumente, prona apo asete të Ndërmarrjes për Autoritetin e Likuidimit, apo në Gjykatë, për t'i ikur proceseve dhe procedurave të këtij Ligji, do të mbahet përgjegjës për gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë (100.000) Euro për secilin rast. Në rast të personit fizik, ai person mund të ndiqet penalisht në pajtim me Kodin Penal.